

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com




Viti XXIV - Nr. 7674 E martë 9 Tetor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion *i* Ditës

Fjalimi i Edi Ramës para deputetëve është përshkuar nga një logjikë absurde: "Ne qeverisim, opozita gabon". Sipas tezave të tij, të shqiptuara me ...
Vijon në faqen 20

Nga ANDI BUSHATI


Rama qeveris, fajet i bën opozita!


Opinion *i* Ditës

Në Kosovë gjatë kësaj jave pritet që partitë politike parlamentare të takohen për të harmonizuar qëndrimet për një qasje të përbashkët në dialogun me Serbinë ...
Vijon në faqen 21

Nga "DEUTSCHE WELLE"

Qeveria dhe opozita përipiqen të harmonizojnë qëndrimin për dialogun me Serbinë



Ekskluzive/ Zbulohet korrespondenca e Ramiz Alisë dhe Hysni Kapos

Libri i Petro Markos: Enver Hoxha me 20 napolona ndau një vajzë nga i fejuari

Zv.ministri Mantho Bala: Figura e shokut Enver nuk paraqitet drejtë

Nga DASHNOR KALOÇI
Trajtimi i figurës së Enver Hoxhës në një vepër letrare apo edhe në artet figurative nga ana e shkrimtarëve dhe artistëve gjatë periudhës së regjimit komunist të para viteve '90-të ishte një problem me mjaft zarrar dhe paraqiste ...
Në faqet 16-17

SHPERTIMI NE FUSHE-KRUJE, POLICIA MERR NE MBROJTJE TE RENE E FAMILJEN

XHISIELES I VENE TRITOL NE OBORR: JAM E FRIKESUAR

Ngjarja, pas denoncimit të vajzës se u përdhunua nga djali i deputetit të PS-së. Kryeministri: Nëse Balla ka qenë në komisarit, të arrestohet



(Në foto) Xhisiela Maloku duke folur për gazetaret Në faqet 2-3

ULTIMATUMI I PD

Berisha i nxjerr videon me bosin e kokainës, Balla: Këtë herë s'ia hedh lehtë
Në faqen 4

VRASJA TE BLOKU

Ervis Martinaj: Nuk u bë sherr për femër, shkova të sqaroheshim, arma shkrepri pa dashje
Në faqen 11

SPECIALE

Ja kush janë fëmijët "sekretë" të VIP-ave e prirja për t'u vendosur bebeve emra shqiptarë
Në faqen 12

KOLEKSIONI

Nadar, njeriu që fotografoi Dymanë e Bodlerin, për herë të parë në "Marub"
Në faqen 18-19

ALBERT VELIU NDOHET NE KOSOVE PAS NDALIMIT



Aktekspertiza për 'Babalen': Regjistrimet e zërave nuk janë origjinale, ka montazh
Në faqen 10

Shkrimtarja: Jeta ime me Ismailin dhe peripecitë me byronë politike për veprat

Rrëfihet Helena Kadare: Momenti ynë më i keq në jetë

"E lashë letërsinë, duke besuar te letërsia e madhe e Kadaresë"

NGA FATMIRA NIKOLLI
E lashë letërsinë duke besuar te letërsia e madhe e Kadaresë... Momenti më i keq në jetën tonë ka qenë debati për poemën "Në mesditë" kur u mbledh byroja politike". Helena Kadare është në "Sonder" në Prishtinë,



e ftuar të flasë për letërsinë dhe jetën e saj pranë shkrimtarit Ismail Kadare. Ajo ka qenë për herë të parë në një rrëfim për letërsinë dhe jetën si bashkëshorte e shkrimtarit të madh para lexuesit të Kosovës. E vënë përballë gazetareve Beti Njuma ...
Në faqen 19

RASTI "XHISIELA" NGJARJA

Policia merr në mbrojtje të renë dhe familjarët e saj, shoqërohen 9 persona

Shpërthim në Fushë-Krujë, tritol në oborrin e shtëpisë së Xhisiela Malokut

25-vjeçarja: Ndihej e frikësuar. Sulmi nga opozita, pasi i nxora bluf në lojën e tyre politike

FUSHË-KRUJË

Një shpërthim me eksploziv ka ndodhur në orët e vona të mbrëmjes së të dielës, në fshatin Larushk të Fushë-Krujës. Mësohet se persona ende të paidentifikuar kanë vendosur një sasi të vogël lëndë plasëse në oborrin e përbashkët të banesave të Besim Muçës dhe Ramazan Muçës, ky i fundit gjyshi nga nëna i 25-vjeçares Xhisiela Maloku, rasti i së cilës ka trazuar kohët e fundit politikën shqiptare dhe mediat, pasi denoncoi të dashurin e saj, djalin e deputetit të PS-së, Rahman Rraja për dhunë dhe më pas u tërhoq nga ky denoncim. Burime zyrtare nga policia bënë me dije se eksplozivi (rreth 100 gr) është hedhur nga rruga drejt cepit të oborrit, rreth orës 23:30, por fatmirësisht si pasojë e shpërthimit nuk ka pasur të lënduar dhe as dëme materiale. Paralajmërimi me tritol është bërë ndaj banesës së gjyshit të Xhisielës, ku kjo e fundit jeton së bashku me nënën dhe motrën. Menjëherë pas sinjalizimit për shpërthimin në fjalë, blutë kanë shkuar në vendngjarje dhe kanë nisur hetimet për identifikimin dhe vënien në pranga të autorëve të krimit. Në lidhje me këtë ngjarje janë shoqëruar dhe marrë në pyetje 9 persona. Pas sulmit me tritol, Xhisiela Maloku si dhe të afërmit e saj janë marrë në mbrojtje nga policia. Një makinë policie me disa efektivë janë vendosur tek banesa ku jeton 25-vjeçarja. Mësohet se policia ka marrë plan masash për sigurinë e vazhdes dhe familjes së saj, pasi prej disa ditësh është në qendër të vëmendjes së kronikës dhe politikës. Ndërkohë, vetë Xhisiela në një prononcim për mediat tha se gjithçka është bërë nga PD dhe opozita dhe se ajo nuk është e kërcënuar nga fisi Rraja.



Xhisiela Maloku, duke folur për mediat



Banesa e Ramazan Muçës, ku ndodhi shpërthimi

REAGIMI I XHISIELA MALOKUT

Pak orë pasi shtëpia e gjyshërve të saj u tronditi nga shpërthimi i eksplozivit, Xhisiela Maloku ka folur për mediat. 25-vjeçarja u shpreh se sulmi ka ardhur nga radhët e opozitës, pasi ajo i nxori bluf në lojën e tyre politike. Ajo ka qenë në të njëjtën linjë me kryeministrin Rama, duke bërë përgjegjës opozitën për gjithë sa ndodhi. Edhe pse tha se nuk do të kishte më dalje mediatike, në një prononcim për mediat, nga makina e saj tip "Peugeot", Xhisiela Maloku tha se nuk është e kërcënuar nga fisi Rraja. "Mendoj se është mëse e qartë që është bërë nga PD-ja dhe opozita për të sulmuar drejtpërdrejt. Unë nuk jam e kërcënuar nga fisi Rraja, deri dje hipotezat ishin se

jam e kërcënuar nga fisi Rraja, tashmë nuk jam dhe telefonata e parë që më është bërë pasi ka ndodhur shpërthimi ka qenë e një kushëri të Rexhepit. Ramazan Rraja ka ardhur këtu dhe më pas është larguar, sepse unë nuk doja që... pastaj ka lajmëruar policinë.

Opozita luajti një lojë politike dhe doli bluf. Unë jam Xhisiela dhe të vërtetën e di unë dhe vetëm unë dhe askush nuk mund të hedhë hipoteza. Deri dje nuk isha e rrezikuar, tashmë mendoj se ndihem e rrezikuar nga opozita. Deri dje mbrojtjen nuk e kam pranuar se nuk kam qenë e kërcënuar. Me Rexhepin nuk kam komunikim, kam marrëdhënie të mira me të, jam sqaruar, kam komunikim me familjarët e tij. Sot i kam kërkuar që të

SKANDALI

Shpërthimi vjen pak ditë pas shpërthimit të skandalit, ku Xhisiela Maloku u dhunua nga djali i deputetit të PS, Rahman Rraja, që i ka mohuar akuzat. Gjithashtu edhe vetë vajza mohoi se është dhunuar, por se e kishte denoncuar ish-të dashurin Rexhep Rraja për xhelozji, pavarësisht ekspertizës së mjekëve dhe psikologut. Aktualisht Rexhep Rraja ndodhet në burg.

DEKLARATA

"Unë jam Xhisiela dhe të vërtetën e di unë dhe vetëm unë dhe askush nuk mund të hedhë hipoteza. Deri dje nuk isha e rrezikuar, tashmë mendoj se ndihem e rrezikuar nga opozita. Deri dje mbrojtjen nuk e kam pranuar se nuk kam qenë e kërcënuar. Me Rexhepin nuk kam komunikim, kam marrëdhënie të mira me të, jam sqaruar, kam komunikim me familjarët e tij".

më qëndrojë pranë një ndër familjarët e tij, sepse vetëm aty ndihem e sigurt për të më mbrojtur. Ai mund të jem pronocohet, por jo në praninë e kamerave. Unë do të jem nën shoqërinë e atij, le të thonë çfarë të duan", u shpreh Xhisiela Maloku për mediat. Gjithashtu, e reja pohoi se kishte qenë në shtëpi në momentin e shpërthimit, ndërsa theksoi se nuk ka ndërmend të kërkojë azil dhe nuk do të largohet nga Shqipëria. "Po, isha në shtëpi kur u hodh eksplozivi. Patjetër që u tremba, ishte një shpërthim i fuqishëm, por tani nuk do të trembem, sepse gjithçka bëhet që unë të kërkoj azil, të fajësoj njerëz të pafajshëm. Unë nuk do të kërkoj azil, sepse nuk do të largohem nga Shqipëria", tha 25-vjeçarja.



Xhisiela Maloku


PARALAJMËRIMI

Burime zyrtare nga policia bënë me dije se eksplozivi (rreth 100 gr) është hedhur nga rruga drejt cepit të oborrit, rreth orës 23:30, por fatmirësisht si pasojë e shpërthimit nuk ka pasur të lënduar dhe as dëme materiale. Paralajmërimi me tritol është bërë ndaj banesës së gjyshit të Xhisielës, ku kjo e fundit jeton së bashku me nënën dhe motrën.

NGJARJA

Gjyshja e Xhisielës: U trembëm shumë, na e hodhën tritolin në oborrin e shtëpisë

FUSHE KRUJË. Pas vendosjes së tritolit në shtëpinë e gjyshit të Xhisiela Malokut, ka ardhur edhe dëshmia nga familjarët. Ata kanë treguar dje për "Panorama.com.al" se janë trembur nga kjo ngjarje dhe se ndjehen të kërcënuar. "Nuk dimë asnjë gjë. S'ia vendosim dot fajin asnjërit. Ishte ora rreth 12 e natës. U trembëm shumë. Na e hodhën tritolin në oborrin e shtëpisë. Jemi të kërcënuar. Nuk kemi asnjë ide kush mund ta ketë hedhur, vetëm kur dëgjuam zhurmë dolëm të frikësuar përjashta dhe pamë se kishin hedhur lëndë plasëse", ka qenë kjo dëshmia e gjyshes së Xhisielës. Familjarët e tjerë nuk pranuan të flasin edhe pse kanë shkuar forca të shumta policie në vendngjarje dhe po punohet për zbardhjen e saj. Vetëm pak ditë më parë, Ramazan Muça, gjyshi i Xhisielës e quajti debatin e krijuar mes mbesës dhe djalit të deputetit si një çështje mes dy të rinjve. Vetë 25-vjeçarja nuk jep një përgjigje të prerë kur bëhet fjalë për lidhjen e saj me Rexhepin, i cili u la në burg nga Gjykata e Krujës.





EDI RAMA

"Nuk të vjen zëri dhe s'ke faj! E di dhe unë sa thellë je futur miku im, po s'të ndihmoj dot. Nuk ecet me teatër se ja si vjen puna, del një aktor i papaguar e të nxjerr cullak! Po me kamerat e komisaritit si i bëhet(?) se aty as Taulanti, as ai polici s'janë fare! Apo po fle ti tani?", u drejtua dje Rama, Bashës.



LULZIM BASHA

"Piktori i dështuar është zhytur në artin e telenovelave, shkruan, dirigjon, interpreton dhe lu servit shqiptarëve përditë nga një shfaqje bajate, ku kriminelët janë heronj dhe ku krimi është virtyt. Shqipëria nuk ka më kryeministër. Shqiptarët nuk kanë më qeveri që mendon e punon për ta dhe hallat e tyre", u shpreh dje Basha.

Kryeministri: Nëse Balla ka qenë në komisarit, të arrestohet

"Xhisiela" e "Babale", Rama: Je futur thellë miku im. Basha: Të tund krimi

Audiopërgjimi, kreu i PD-së: Nxirr ekspertizën e videos

Tritoli, Berisha: Rama thirri në ndihmë viktimën Xhisiela Maloku

Ish-kryeministri Sali Berisha iu është bashkuar reagi lmeve pas ngjarjes që ndodhi sot në Fushë-Krujë, ku banesës së gjyshit të Xhisiela Malokut iu vendos tritol. Përmes një statusi në "Facebook" Berisha pohon se 25-vjeçarja ka certifikuar kryeministrin Edi Rama si kryepërdhunuesin. Berisha theksoi se Rama pasi akuzoi opozitën për vendosjen e tritolit, thirri për ndihmë me detyrim Xhisielën, e cila sipas tij deklaroi gërmë për gërmë fjalët e kryeministrit. "Viktima XH.M. certifikon Ramën si kryepërdhunues! Të dashur miq, pas vendosjes së tritolit te gjyshërit e XH.M., Edvin Kristaq Rama deklaroi se tritolin e vendosi opozita, duke treguar kështu tmerrin e brendshëm që e ka kapur si kryepërdhunues i shtetit përdhunues. Ai, për të shpëtuar nga ky tmerr thirri në ndihmë me detyrim viktimën XH. M., e cila deklaroi gërmë për gërmë dhe fjalët për fjalët atë që tha dy orë më parë Edi Rama, duke akuzuar dhe faktuar kështu përfundimisht me fjalët e saj tekstuale me të Edvinin se ai është kryepërdhunuesi i shtetit përdhunues!", shkroi Berisha në "Facebook".

Paloka: Këta kalojnë edhe fantazinë, deklarimi i vajzës jashtë parashikimeve

Deputeti i Partisë Demokratike, Edi Paloka ka reaguuar menjëherë pas komenteve të Xhisielës, se tritolin në shtëpinë e gjyshërve e ka vënë opozita. Në një status në "Facebook", Paloka u shpreh se diçka e tillë del jashtë parashikimeve të tij. "Këta kalojnë dhe fantazinë... Që mund ta nxirrin atë vajzën të deklaronte se e kishte vënë vetë tritolin e mendova, po që të deklaronte pas Ramballes, se ia kishte vënë opozita, nuk arrita ta imagjinoja. Ja pra dhe bomba në ambasadën jugosllave u gjet... Rama i kalon vërtetë me distancë paraardhësit e tij në të keqe", shkruan ai. Edhe pse tha se nuk do të kishte më dalje mediatike, në një prononcim për mediat nga makina e saj, Xhisiela Maloku deklaroi se gjithçka është bërë nga PD dhe opozita dhe se ajo nuk është e kërcënuar nga fisi Rraja. "Mendoj se është mëse e qartë që është bërë nga PD dhe opozita për të sulmuar drejtëpërdrejt. Unë nuk jam e kërcënuar nga fisi Rraja, deri dje hipotezot ishin se jam e kërcënuar nga fisi Rraja, tashmë nuk jam dhe telefonata e parë që më është bërë pasi ka ndodhur shpërthimi ka qenë e një kushëriri të Rexhepit", - u shpreh Xhisiela për mediat.

Darina Tanushi

Tritoli në shtëpinë e gjyshit e xhaxhit të Xhisiela Malokut rindezi dje debatet mes kryeministrit dhe kreut të opozitës. Në një reagim të tij, në mbledhjen e grupit parlamentar të PS-së, kryeministri Edi Rama mori në mbrojtje kreun e grupit socialist, Taulant Balla. "Mbrëmë natën, vajzës së kthyer në 'mish për topat' e kësaj politike të ulët i është hedhur lëndë plasëse në shtëpi. Kush është i interesuar të krijojë në publik idenë se vajza është nën trysninë e një terrori psikologjik? Ne?! Jo! Nuk ka mendje normale, madje edhe peshqit e liqenit artificial e kuptojmë që për këtë kanë interes vetëm ata që e dhunuan publikisht për ditë e ditë të tëra dhe askush tjetër", u shpreh dje Rama. Duke iu referuar kërkesës së PD-së për të përjashtuar Ballën nga delegacioni parlamentar i Stabilizim-Asocimit, Rama iu drejtua njëri prej firmëtarëve, ish-ministres së tij të Integritimit, Kalljës Gjosha, duke i thënë: "E dashur Klajda, qetësohu! Taulanti është ai që ka qenë kur bashkëpunoj me të si drejtues i delegacionit. Ai nuk e ka bërë kurrë atë që e ka tronditur kaq shumë Monikën dhe për pasojë edhe ty, sa të bashkohesh zërin në atë kujë drejtuar Parlamentit Europian. Materialet filmike të Komisaritit të Krujës në ditën e ngjarjes të denoncuar nga heroi i 'Babale 2' sht janë në prokurori. Por si deputete, thellësisht e shqetësuar nga mundësia e qëndrimit në një delegacion me një kriminel të armatosur dhe të maskuar si kryetar delegacioni, ti mund t'i



Kryeministri Edi Rama

YLLI MANJANI

Ish-ministri i Drejtësisë, Ylli Manjani theksoi se pavarësisht deklaratave, jetën e 25-vjeçares nga Fushë-Kruja dhe familjes së saj duhet ta mbrojtë shteti. "Nejse, përtej deklaratimit politik të Ramës, atë vajzë dhe familjen e saj duhet t'i mbrojtë shteti. Shteti dhe vetëm ai përgjigjet për jetën e tyre!", shkroi Manjani.

drejtoresh policisë me kërkesën për të parë ato materiale". "Nëse do gjehe gjëkund në ato filmime Taulant Ballën, apo ofitë edhe vetë heroinë, të cilin Taulanti e paska kërcënuar me pistoletë në kokë, unë do votoj bashkë me ty, jo për të hequr Taulantin nga drejtimi i delegacionit për Brukselin, por për t'i hapur rrugë arrestimit të tij, pasi ta kem kallëzuar po unë dhe ti në prokurori", tha më tej Rama. Duke folur për opozitën, Rama u shpreh: "Hiq çizmen dhe vrap me gjuhën jashtë do të vazhdojnë përditë këta që kemi kusurim të kemi përballë. Lejha sa gdhihet deri kur ngryset dhe 'të dalë, ku të dalë motra'. Kjo është opozita. Sot, djali i një deputeti është

në burg. Më vjen shumë keq për Rrahmanin, se po kalon një moment tejet të vështirë, pranë shtratit të spitalit ku e shoqja po lufton me vdekjen dhe natyrisht, edhe si baba, me një djalë që është aty ku e meriton të jetë", u shpreh më tej Rama. **"BABALJA"** E duke e lidhur me audiopërgjimin, që sipas ekspertizës së britanikëve doli që ishte montazh, Rama u shpreh se, "vëllai i ministrit në atë audiopërgjim është një aktor. Më saktë, një mjeran i joshur për ta luajtur atë rol në këmbim të parave. Unë i bëj thirrje prokurorisë që t'i çojë deri në fund hetimet e 'Babale 1' pa u kompleksuar nga kërcënimet dhe sulmet e dëshpëruara të PD-së", theksoi Rama.

Kryeministri tha se do të çojë shumë shpejt në Kuvend paketën antishpije, jo për të mbyllur rrugët e lirisë së shprehjes, por që secili t'i dalë për zot asaj që thotë. Nga ana e tij, kreu i opozitës, Lulzim Basha u shpreh: "Shqipëria nuk ka më kryeministër. Shqiptarët nuk kanë më qeveri që mendon e punon për ta dhe hallat e tyre. Në vend të sigurisë, punësimi e mirëqenies, tani e tutje shqiptarët do të kenë vetëm telenovela. Ndërkohë qeveria, policia dhe prokuroria punojnë çdo ditë për t'u garantuar sigurinë, qetësinë dhe paratë kriminelëve. Sepse Rama mendon dhe vepron vetëm për të mbrojtur kriminelët. Ndaj çirret e betohet nga mëngjesi në darkë për të mbrojtur Tahirin, Xhafajan, Ballën, Rrajën, Çyrbjen, Gjushin, e kriminelët e lidhur me ta. Edi Rama nuk është më kryeministër, por vetëm një dorleqë që krimi e tund përditë në publik për të kërcënuar dhe trembur shqiptarët", tha Basha. "Por shqiptarët nuk tremben. Unë as trembem dhe as shantazhohem, sepse nuk jam peng i krimi. Sepse kurrë nuk më ka lidhur asgjë me kriminelët, sepse sado t'i mbrojtë Rama kriminelët dhe mbrojtësit e tyre, ata të gjithë do të përfundojnë atje ku e kanë vendin. Kreu i PD-së, Basha kërkoi nga Rama të nxjerrë ekspertizën e audiopërgjimit. Por më pas, Rama reagoi sërisht duke i thënë: "Lëri reagimet trimërore si ato të kënduarat natën për të larguar gogolët. Ty s'të ka lidhur asgjë me kriminelët? Tije artist. Tani tregoj shqiptarëve kush të lidhi me poetin Babale dhe kush e çoi nga zyra jote tek gazetari. Ah, mos harro kamerat e Krujës para se të flesh prapë".

KRIMINALITETI AKUZAT

"Fotomontazh"? Ish-kryeministri publikon videon. Balla: S'do ia hedhësh lehtë

Berisha nxjerr videon: Balla me bosin e kokainës

"Ultimatumi për sekretarin e përgjithshëm të PS-së"

Valentina Madani

Ish-kryeministri Sali Berisha fillimisht akuzoi me foto, por dje e vazhdoi me video akuzën ndaj Taulant Ballës. Z.Berisha publikoi një video ku pretendon se është kryetari i grupit parlamentar të PS, Taulant Balla nën shoqërinë e një personi që është arrestuar në 2015-ën për trafik droge. "Ja dhe Taulant Bego/Jaris, që botohej dje se është e montuar foto e tij me bosin e kokainës, Maksim Beço, të arrestuar në vitin 2015 nga policia për kokainë!", shprehet z.Berisha. Dy ditë më parë ish-kryeministri publikoi një foto të Ballës me Maksim Beçon, ku shkruante: "Taulant Bego/Jaris me bosin e kokainës, Maksim Beço, të arrestuar nga policia për trafik kokainë në vitin 2015!". Por, ndërsa u përball me akuzat se fotoja e Ballës dhe Beços në një arë ishte fotomontazh, Berisha i dedikoi një tjetër status rastit, për të nënvizuar ndryshimet mes fotos për të cilën aludohej se ishte marrë Balla dhe ishte vendosur me Beçon. Ish-kryeministri Sali Berisha mesditën e djeshme i dha një ultimatum kreut të grupit parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Ballës. Berisha paralajmëroi se do të nxjerrë në tavolinë letrat. Ai publikoi mesazhin e qytetarit që i ka siguruar edhe foton e parë, i cili i dha ultimatum Ballës që deri në orën 14:00 të kërkonte ndjesë publike se fotoja me të arrestuarin për trafik droge është montim. "Ultimatum i qytetarit dixhital për Taulant Bego/Jaris! S'b lidhur me mashtrimin tuaj se fotoja me të arrestuarin nga policia, Maksim Beço është montim, në rast se nuk kërkon ndjesë publike gjër në ora 14:00 të ditës së sotme (djeshme) për fyerjen që më ke bërë, do përballësh me publikim dokumentesh përvëluese". Më pas Berisha publikoi videon që implikon sekretarin e përgjithshëm të PS-së. Taulant Balla reagoi pas publikimit të videos nga

ish-kryeministri Sali Berisha. Nën një status në "Facebook", Balla riposton statusin e Maks Beços, personit që për të cilin Berisha thotë se është trafikant droge. Kreu i krupit par-

lamentar i kërkon Berishës t'i lërë montazhet e të mos digjet si Luli, duke e kërcënuar se ka punë me drejtësinë. "O Sali, zgjidhe vetë me këtë mbështetësin tënd, lëri montazhet se mirë

Luli u dogj me babalet. Po aman mos u digj edhe ti, sepse ti ke punë me Drejtësinë, nuk do ta hedhësh lehtë. Hajt je se burri i vjetër", shkruan Balla. Por, pas akuzave të djeshme të ish-kryeministrit reagoi edhe vetë personi i përfolur Maksim Beço. Në një status në "Facebook", Beço shkruante se e ka pasur idhull Berishën dhe se gjithmonë në Shqipëri ka votuar për të dhe nuk e priste që ish-kryeministri ta bënte mik me Taulant Ballën. "Sali Berisha, Maksim Beço jam, të kam pas idhull. Nuk e prisja që do më bëje mik me zor të këtij ushtarit të Edi Ramës. Nuk e kam takuar ndonjëherë këtë Taulantin e PS. Sa kohë kam qenë në Shqipëri, kam votuar vetëm për ty. Nuk e prisja që ti një ditë do merresh me mua", shkruan Beço.



Ish-kryeministri Sali Berisha

"Procedura e përzgjedhjes, jotransparente"

Kandidatura për "Strasburgun", Shehu: Propozimi, pa veting

Deputeti i PD-së, Tritan Shehu ishte i pranishëm dje në grupin parlamentar të PPE-së në Këshillin e Europës, ku bëri publike shqetësimet e opozitës për propozimet e qeverisë për Gjykatën e Strasburgut. Shehu theksoi se procedura e përzgjedhjes është zhvilluar e mbyllur dhe pa asnjë transparencë, si dhe pa u marrë mendimi i Kuvendit dhe opozitës dhe pa u nënshtruar vetingut. Ai akuzoi se qeveria po tenton jo vetëm të kapë drejtësinë në Shqipëri, por edhe të penetrojë ilegalisht në strukturat e tilla jashtë vendit. "Mbas një komunikimi disamujor tonin me strukturat e nivelet e ndryshme të Këshillit të Europës në lidhje me 'propozimin' e kandidaturave të dërguara nga qeveria shqiptare për gjykatën



Deputeti i PD-së, Tritan Shehu

AKUZA

"Në të gjithë atë proces 'përzgjedhjeje' është implementuar një praktikë jo korrekte, e fshtë, shumë larg standardeve të domosdoshme dhe e dyfishtë në krahasim me atë çfarë kërkohet së paku formalisht, për të tjerët në vend", tha z.Shehu.

pranë tij, sot kjo çështje u diskutua edhe në grupin parlamentar të PPE. Në ato komunikime të mëparshme, kryetari Basha ka denoncuar disa herë faktin se procesi i përzgjedhjes se tyre në Shqipëri është bërë larg rreg-

ullave të nevojshme e principeve demokratike, duke qenë në vazhden e kapjes së drejtësisë nga Rama. I ringrit këto shqetësime në grupin e PPE të Asamblesë së Këshillit të Europës", deklaroi deputeti i PD-së.



Kreu i PD-së, Lulzim Basha, gjatë prezantimit të djeshëm të platformës zgjedhore

STATUSI

Ndërsa u përball me akuzat se fotoja e Ballës dhe Beços në një arë ishte fotomontazh, Berisha i dedikoi një tjetër status rastit, për të nënvizuar ndryshimet mes fotos për të cilën aludohej se ishte marrë Balla dhe ishte vendosur me Beçon. Ish-kryeministri Sali Berisha mesditën e djeshme i dha një ultimatum kreut të grupit parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Ballës. Berisha paralajmëroi se do të nxjerrë në tavolinë letrat.



"Egërsia e shtetit nuk njeh kufij"

Nishani: Shteti ka rënë, alternativa e vetme është rivendosja e ligjit

Ish-presidenti Bujar Nishani, teksa numëron të gjitha faktet që sipas tij tregojnë qartë se tashmë shteti ka rënë totalisht, flet për alternativën e vetme që ka përballë vendi dhe çdo shqiptar. "E vërteta kërkon drejtësi dhe drejtësia do bëhet. Nuk ka alternativë! Alternativa e vetme është rivendosja e shtetit ligjor. Atë ditë e tutje, do të nisë saga e keqëresve. Të të gjitha llojeve", - shkruan Nishani në "Facebook". Duke iu referuar rastit më të fundit, të nënkomisar Nuhut, që u detyrua sipas tij, të lërë vendin përballë kanosjes, Nishani kujton se me çfarë u përball kur kërkoi të hetohej deri në fund denoncimi i Zaganit. "Egërsia e pushtetit nuk njihet kufij. Në atë kohë si president i republikës, kërkova të merreshin seriozisht denoncimet e oficerit dhe të hetohej plotësisht, por si reagim presidenti mori sulmet, sharjet dhe fyerjet e kryeministrit të vendit", - shkruan shprehet z.Nishani.

Shitje me Ankand të dyte nga Studio Permbairmore L.D.C
 Shitje me Ankand të dyte nga Studio Permbairmore L.D.C
 -Apartamentin me nr. 2/260+2-6, vol 30, faqe 140, sip. 104.12 m2, ZK 8330, regjistruar me Z.V.R.P.P. Tirane. Çmimi fillestar për shitje është 4.700.000 L.e.
 Data e shpalljes 11.09.2018
 Data e zhvillimit 11.10.2018 deri në orën 16.00
 Ankandi zhvillohet në ambientet e Studios Permbairmore L.D.C me adresë Rruga "Myslym Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tirane.



Platforma e opozitës për "çlirim e zgjedhjeve": Kuvend me dy dhoma dhe 100 deputetë

Basha: Të fortët dhe bandat që PS angazhoi në vjedhjen e votave

"Prokuroria ka biseda telefonike me kriminelët"

Valentina Madani

Kreu i PD-së, Lulzim Basha prezantoi dje platformën zgjedhore, me synimin kryesor sipas tij, çlirimin e zgjedhjeve nga krimi, nga shitblerja e votës dhe korrupsioni, si dhe nga kapja shtetërore. Z.Basha prezantoi katër shtyllat, të cilat siç tha, ai do të çlirojë zgjedhjet nga shitblerja e votës. "Po nuk u nda politika nga krimi, nuk ka shans për zgjedhje të lira e të ndershme. Ngjarjet kriminale të ditëve dhe javëve të fundit kanë pasur një të përbashkët: kudo ku ka krime të rënda, ka lidhje të autorëve me zgjedhjet. Opozita nuk konkurren me socialistët, por me kriminelët", deklaroi z.Basha. Kreu i PD-së prezantoi katër pikat kryesore të platformës së opozitës për garantimin e votës, që nisin me dekriminalizimin e procesit zgjedhor, brenda së cilës është pjesë kryesore dhe shumë e rëndësishme është edhe vetingu në politikë. "Së dyti, sistemi i masave kundër shitblerjes së votës, e cila është evidentuar si problemi kryesor në raportin e OSBE-ODIHR. Blerja e votës jo vetëm do të konsiderohet korrupsion zgjedhor, por kërkohet një sërë masash që duhet të nisin që në gjenezën e procesit të blerjes së votës, jo pak javë para, por deri në 12 muaj para zgjedhjeve. Së treti, financimi i partive, financim shtetëror 100% i fushatës, ndërkohë që kompanitë që financojnë partitë e kandidatët të përjashtohen nga tenderat e koncesionet. Dhe së katërti, përdorimi i teknologjisë në votim, numërim dhe votim elektronik", - tha Basha. Sipas tij, më parë duhen zgjidhur këto çështje kaq thelbësore, e më pas mund të kalohet në detaje, si parlament me dy dhoma dhe ulje e numrit të deputetëve nga 140 në 100 deputetë. Z.Basha akuzoi se kudo që ka krime të rënda, ka lidhje të autorëve me zgjedhjet. Sipas kreut të PD, bandat janë kthyer në faktorin më të rëndësishëm zgjedhor për socialistët. Ai renditi një sërë grupesh kriminale, që sipas Bashës tregojnë lidhjet e pushtetit me krimin në çdo qark. "Në prokurori ka përdorime telefonike mes Ulsi Manjës, Damian Gjikonit, Taulant



Kreu i PD-së, Lulzim Basha

PREZANTIMI
Deputeti i PD-së, Oerd Bylykbashi dhe Ivi Kaso, këshilltar ligjor në PD bëri publik nisim duke thënë se, "platforma jonë ka evidencuar një sërë masash emergjente për të dekriminalizuar procesin zgjedhor".

SISTEMI

"Qëndrimi im personal është që për çfarëdo sistemi të shkojmë, maxhoritar, proporcional, proporcional kombëtar duhet një diskutim i hapur dhe i thelluar për të arritur mënyrën më të mirë përfaqësimit të vullnetit të qytetarëve. Reduktim i numrit të deputetëve me 100? Pse jo", theksoi kreu i PD-së.

PLATFORMA E OPOZITËS PËR ZGJEDHJET

1. Dekriminalizimi i procesit zgjedhor, ku përfshihet edhe vetingu i politikanëve.
2. Masat kundër shitblerjes së votës.
3. Reduktim i shpenzimeve të fushatës, financim shtetëror 100%.
4. Përdorimi i teknologjisë në votim, votim dhe numërim elektronik.

Ballës dhe Edi Ramës me grupe kriminale", - tha z.Basha. Ai dha alarmin se situata politike është e rëndë, saqë Partisë Demokratike i duhet të përballet jo me socialistët, por me kriminelët. Basha përmendi emra, të cilat sipas tij kanë ndikim në politikë. "Kudo ku ka krime të rënda, ka lidhje të autorëve me zgjedhjet. Bajrët në Shkodër e njëjta gjë në Elbasan, nga Çelajt tek Sanxhaktarët me shokë, në Durës bandat e Berishës, Plarënt Dervishit. Në Dibër Ymer Lala, në Korçë Ragami, në Tiranë, ndonëse në arrest dhe disa në burg janë Shullazi tek Dritan Dajti", theksoi z.Basha. Kreu i PD-së la të hapur

edhe mundësinë për ndryshime të tjera në Kodin Zgjedhor si ndryshimin e numrit të deputetëve nga 140 në 100 dhe ndarjen e parlamentit në dy dhoma. Në dekriminalizim do të përfshihet vetingu i politikanëve dhe policisë nga struktura të pavarura, ndërsa fushata zgjedhore duhet të finanohet 100% nga buxheti i shtetit. Për mbulimin mediatik, PD është më e vazhdueshme kur shprehet se duhet të ndiqen praktikant ndërkombëtare, duke e lënë të paqartë këtë pikë. Sa u takon masave për shitblerjen e votës, PD propozon krijimin e Task Forcës, duke iu referuar edhe eksperiencës gjatë qeverisjes teknike në 2017.

Shehi: Opozitën e mban të bashkuar Edi Rama

Dashamir Shehi deklaroi se "opozita mikse që është sot mbahet në këmbë vetëm nga Edi Rama. Ditën që Rama nuk do të jetë më, opozita nuk do të jetë kaq homogjene. E kuptojmë që pushteti i Ramës është kaq abuziv, arrogant dhe antiligjor saqë janë bashkuar njerëz që kurrë nuk do të bëheshin bashkë në kushte të tjera", deklaroi kreu i Lëvizjes për Zhvillim Kombëtar. Shehi theksoi në emisionin "Top Talk" se marrëveshja që ka me Lulzim Bashën është e thjeshtë, të rrëzojë Edi Ramën. Gjithsesi, kryetari i LZHK-së pranoi se sistemi zgjedhor është defekt, por që do të diskutohet pas përmbytjes së qëllimit kryesor të opozitës. "Sistemi zgjedhor është defekt i madh dhe zoti Basha e pranoi vetë që pasi të pastrohet procesi nga vjedhja e votave, do të merremi me sistemin, që sipas meje, sot është i pavlefshëm. Që të funksionojë përfaqësimi real i vlerave duhet sistem që të ketë një element mazhoritar, ose zonat mazhoritare, ose listë të hapur. E dyta, të jetë kombëtar, jo rajonal. Por, aktualisht jemi të faza e parë. Nëse qytetari dhunohet kur shkon te kutia e votimit, asnjë sistem, as më i miri, nuk ka vlerë", theksoi Shehi.

FINANCIMI

"Kompani që financojnë parti politike dhe kandidatë do të përjashtohen nga përfillimi i tenderave dhe koncesioneve për një kohë të përcaktuar. Kjo masë në fakt do të parandalojë korrupsionin dhe trajtimin preferencial të kompanive financuese të partisë fituese të zgjedhjeve në tendera dhe koncesione", - tha z.Basha.



Luan Rama: Shqipëria, "njolla e zezë" e vjedhjes së votës

Zëvendëskryetari i LSI-së, Luan Rama shpjegoi dje qëllimin e platformës së opozitës për zgjedhje të lira. I ftuar në "News 24", Rama theksoi se kjo platformë do t'u japë mundësi qytetarëve që t'u njihet vota demokratike. Po ashtu, Luan Rama nënvizoi faktin se në parlament ka pasur dhe ka politikanë me producente penale, ndërsa shtoi se Shqipëria vijon të jetë njolla e zezë në Europë ku vidhen zgjedhjet. "Platforma që kemi prezantuar sot për të çliuar zgjedhjet nga krimi nuk mund të ezaurojë të gjithë problematikën që kanë shfaqur zgjedhjet që në '91. Ne ofrojmë një mundësi jo thjesht diskutimi, dialogu, për të qenë në kohezion me shtetësimin e qytetarëve, por edhe mundësi për të tërhequr vëmendjen me atë që ka të bëjë me kriminalizimin e zgjedhjeve. Me zgjedhje që realizohen nën autoritetin e krimi, prej nga ku burojnë lidhjet e krimi me politikën. Nuk ka sens, arsye që ta perceptojë se si ndodh në 2018-ën që Shqipëria të jetë i vetmi vend në Europë me zgjedhje të kontestuara, me zgjedhje të blera. Situata është përkeqësuar më tej. Jemi dëshmitarë të gjithë që në parlament ka pasur dhe ka njerëz me precedentë kriminale. Për të cilët askush nuk mban përgjegjësi. Përsa kohë qeverisja buron nga vota, duke bërë buruar nga një votë e vjedhjes, produkti ky do të jetë. Për të vendosur një standard nuk ka rëndësi se cila është mazhoranca në pushtet, por qytetari duhet të zgjedhë. Që të zgjedhë, duhet të ketë votim demokratik. Duhet të ketë zgjedhje të ndershme, korrekte. Shqipëria nuk duhet të tregohet me gisht si 'njolla e zezë' e vjedhjeve të zgjedhjeve", tha Luan Rama.

REPUBLIKA E SHQIPËRISE
Zyra përbarimorë "Best 2018"

SHPLLALJE ANKANDI

Më datë 19 nëntor 2018 nga ora 08.00-ora.16.00 tek ju zyrë përbarimorë do zhvillohet seanca e fundit mbledhjes së ofertave për ankandin e II-të, për shitjen e pasurisë "MUSHIQI" shpik të ndodhur në L. 13, ZK 8518, Plazh, Durrës.

Prona përbëhet nga dy dyqane (gjithej rreth 245 m2) dhe tre apartamente (gjithej rreth 245 m2) dhe mbi këto pronë nuk rëndësi bënë hipotekë apo nuk janë të kufizuara nga detyrime të tjera.

Çmimi fillestar për çdo apartament do të jetë 37800 lek/m2, ndërsa çmimi fillestar për dyqan do të jetë 56700 lek/m2.

Për sqarime të mëtejshme kontaktoni në tel: 052226000 ose cel: 0692075 644

Komisioni i Punëve të Jashtme në PE diskuton raportin për Shqipërinë

Fleckenstein: Njihet progresi i bërë deri tani për reforma integruese

Komisioni i Punëve të Jashtme të Parlamentit Europian ka diskutuar raportin e Knut Fleckenstein për Shqipërinë. Raporti ka hasur në një mbështetje të gjerë të grupimeve politike. Kjo reflektohet nga fakti se për këtë raport janë prezantuar 23 amendamente, që përbën edhe numrin më të vogël të amendamenteve lidhur me raportet e mëparshme për Shqipërinë dhe krahasuar me raportet për vendet e tjera të rajonit. Gjatë debatit, raportuesi Knut Fleckenstein ka deklaruar se njihet progresi i deritanishëm për reformat e integritimit, por duhet

DEKLARATA

Knut Fleckenstein ka deklaruar se njihet progresi i deritanishëm për reformat e integritimit, por duhet vijuar me zbatimin e tyre. Fleckenstein ka vënë në pah ecurinë e mirë të procesit të vetingut, por ka kërkuar vijimin e zbatimit të Reformës në Drejtësi dhe rezultate konkrete në luftën kundër kimit të organizuar dhe korrupsionit.

vijuar me zbatimin e tyre. Fleckenstein ka vënë në pah ecurinë e mirë të procesit të vetingut, por ka kërkuar

vijimin e zbatimit të Reformës në Drejtësi dhe rezultate konkrete në luftën kundër kimit të organi-

zuar dhe korrupsionit. Raportuesi Eduard Kukan, edhe pse ka njohur progresin e Shqipërisë deri tani, është treguar i ashpër për problematikën e kimit të organizuar dhe korrupsionit në vend, duke thënë se këto probleme po cenojnë ecurinë e vendit në procesin e integritimit europian. Gjatë debatit i është kushtuar vëmendje edhe përmirësimit të drejtave të njeriut, çështjes së pronës, mbrojtjen e pasurive natyrore dhe respektimin e standardeve europiane për hidrocentralin mbi lumin Vjosa dhe hidrocentrale të tjerë.



Knut Fleckenstein

tjes së pronës, mbrojtjen e pasurive natyrore dhe respektimin e standardeve europiane për hidrocentralin mbi lumin Vjosa dhe hidrocentrale të tjerë.

Ministri i Jashtëm në Barcelonë, në forumin e bashkimit për Mesdheun

Bushati: Ndërmarrje kolektive përballë terrorizmit e migracionit të paligjshëm

"Shqipëria, kontribut për sigurinë e rajonit euro-mesdhetar"

Shqipëria ka kontribut për sigurinë e rajonit euro-mesdhetar", deklaroi dje ministri për Europën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati, i cili mori pjesë në Forumin e Tretë Rajonal të Bashkimit për Mesdheun (BpM), që u zhvillua në Barcelonë. Ky aktivitet shënon 10-vjetorin e themelimit të këtij organizmi. Synimi i takimit ishte rigjallërimi i bashkëpunimit euro-mesdhetar, si një përgjigje ndaj sfidave për stabilitetin në këtë rajon. Në fjalën e tij, ministri Bushati vuri në dukje se zona euro-mesdhetare përballë me sfida të tilla si terrorizmi, radikalizmi, apo migracioni i paligjshëm, adresimi i të cilave kërkon ndërmarrjen e veprimeve kolektive të bashkërdhura. "Në këtë kontekst është e nevojshme - theksoi ministri - që të fokusohemi tek dimensionin e zhvillimit njerëzor, duke ofruar më shumë mundësi ndaj rinjve dhe duke siguruar një rritje të qëndrueshme ekonomike, e cila nuk mund të arrihet me nivelin aktual të integritimit ekonomik të zonës euro-mesdhetare. Përveç nevojës për një koordinim më të ngushtë të projekteve të Bashkimit për Mesdheun me Strategjinë e BE-së për rajonin Adriatiko-Jonian, ministri Bushati evidento i edhe domosdoshmërinë për më shumë sinerji me procesin e para-aderimit të vendeve anëtare të Bashkimit për Mesdheun nga Ballkani Perëndimor, me axhendën e konektivitetit si edhe me Zonën Rajonale Ekonomike të rajonit tonë. "Pavarësisht sfidave aktuale, ne besojmë se Mesdheu, si një korridor i madh detar, është një nga rajonet më vitale për zhvillimin e tregtisë dhe duhet të vazhdojë të lulëzojë në botën tonë të globalizuar. Shqipëria mbështet rigjallërimin e Bashkimit për Mesdheun dhe është e vendosur në vizionin e saj për



Ministri për Europën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati, në Forumin e Tretë Rajonal të Bashkimit për Mesdheun

përmirësimin e sigurisë në rajonin euro-mesdhetar", theksoi ministri Bushati. Në kuadër të Ministerialit të Unionit për Mesdheun, ministri Bushati zhvilloi një takim me ministrin e Jashtëm të Jordanisë, Ayman Al Safadi. Ministrat vlerësuan marrëdhëniet shumë të mira

mes dy vendeve dhe intensifikimin e dialogut politik, në kuadrin dypalësh dhe shumëpalësh. Ata ranë dakord për një angazhim më të madh në drejtim të një bashkëpunimi konkret në fushat me interes të ndërsjellët. Ministri Bushati kërkoi mbështetjen e Jordanisë për kandidaturën


e Shqipërisë për vend jo të përhershëm në Këshillin e Sigurimit për periudhën 2022-2023 si dhe për kërkesën e Kosovës për anëtarësim në INTERPOL. Gjithashtu, ministrat shkëmbyen mendime mbi zhvillimet e fundit në rajonet respektive dhe sfidat globale.

DEKLARATA

"Pavarësisht sfidave aktuale, ne besojmë se Mesdheu, si një korridor i madh detar, është një nga rajonet më vitale për zhvillimin e tregtisë dhe duhet të vazhdojë të lulëzojë në botën tonë të globalizuar. Shqipëria mbështet rigjallërimin e Bashkimit për Mesdheun dhe është e vendosur në vizionin e saj për përmirësimin e sigurisë në rajonin euro-mesdhetar", theksoi ministri Bushati.

Soreca: Reforma në administratë, thelbësore për integrimin në BE

Ambasadori i BE-së në Shqipëri, Luigi Soreca ka bërë thirrje për shpejtim të reformës në administratën publike, në mënyrë që Shqipëria të sigurojë një rrugë të qëndrueshme drejt Bashkimit Europian. "Shpejtimi i reformës në administratën publike është thelbësor për Shqipërinë, për të siguruar një rrugë të qëndrueshme drejt anëtarësimin në BE. Me zvkryeminstren Senida Mesi, në gjithashtu diskutuam iniciativat konkrete për të mbështetur më tej barazinë gjinore në jetën e përditshme dhe në mjedisin e punës", shkroi dje në "Twitter" ambasadori i BE-së. Ndërsa zvkryeminstria Mesi u shpreh se gjatë takimit me ambasadorin u nënvizua edhe mbështetja e plotë dhe e vazhdueshme e BE-së. "Diskutuum për reformën në administratën publike, që qeveria shqiptare po ndërmerr, për të cilën u nënvizua edhe mbështetja e plotë dhe e vazhdueshme e BE", tha Mesi.



Agjencia italiane e informacionit, ANSA informoi dje se sipas burimeve diplomatike europiane, Austria e Danimarka po insistojnë në planin e tyre për ngritjen e qendrave për strehimin e emigrantëve të dëbuar nga Bashkimi Europian në vende të treta joanëtare të BE-së, në veçanti në Shqipëri. Sipas ANSA-s, në këto kampe emigrantësh



Austria dhe Danimarka kërkojnë hapjen e kampeve të emigrantëve në Shqipëri

do të strehohen azilkërkues, ndaj të cilëve është marrë vendimi përfundimtar për largimin e tyre nga territori europian e që nuk mund të riatdhesohen në vendet e origjinës, për shkak të mungesës së marrëveshjes mes palëve. Një dokument i tillë

që përmban konceptin e ngritjes së qendrave të emigrantëve në vendet e treta joanëtare të BE është prezantuar edhe më parë në Komitetin Strategjik Europian për Emigracionin. Dhe pse nuk është parashikuar që një çështje e tillë të jetë në

axhendën e punës së ministrave të Brendshëm të vendeve anëtarë që do të mbahet të premtën e ardhshme në Luksemburg, sipas agjencisë italiane të informacionit, me shumë gjasa mund të merret në diskutim.

Ambasadorja gjermane: Synojmë sensibilizimin e të rinjve

Laboratori i lëvizshëm në të gjitha shkollat e Shqipërisë, Nikolla: Mundësi për nxënësit

Shqipëria është i pari shtet në Ballkanin Perëndimor që pajiset me një laborator të lëvizshëm për nxënësit shqiptarë. "Fl Ki Bio" është laboratori që ministria e Arsimit ka marrë si dhuratë nga qeveria gjermane, nëpërmjet autobusit lëvizës me mjetet më të fundit teknologjike, fëmijët në shkollat të ndryshme të vendit do të mund të eksperimentojnë fenomene dhe dukuri natyrore, të cilat i mësojnë në teori në librat shkollorë. Ky laborator dijen e djeshme ishte i vendosur në shkollën 9-vjeçare "Gustav Mayer" në Tiranë ku fëmijët e klasës së 5-të bënë eksperimente të ndryshme. Në këtë ceremoni

OBJEKTIVI

"Është një mundësi më shumë për të gjithë sistemin tonë arsimor, sepse bën të mundur pikërisht atë që ne duam, në fakt, të jetë shkolla, një shkollë pa mure, një shkollë e hapur për të gjithë, një shkollë ku ndërveprohet", - deklaroi ministria Nikolla.

dorëzimi ishte e pranishme ministria e Arsimit Lindita Nikolla dhe ambasadorja gjermane në Tiranë Susanne Schütz. Ministria Nikolla pasi shprehu mirënjohje për këtë dhuratë me vlerë për arsimin shqiptarë deklaroi se ky laborator do të pajisë

brezat e rinj me njohuri dhe argumente të bazuara mbi të vërteta shkencore të cilat do të formësojnë edhe qëndrimet e tyre në të ardhmen. "Është një mundësi më shumë për të gjithë sistemin tonë arsimor, sepse bën të mundur pikërisht atë që ne

duam, në fakt, të jetë shkolla, një shkollë pa mure, një shkollë e hapur për të gjithë, një shkollë ku ndërveprohet, një mësim interaktiv, ku mëson nxënësi, por mëson edhe mësuesi, e mbi të gjitha një shkollë që mundëson aftësi, shprehje, qëndrime, që këta fëmijë meser të jenë të gatshëm për t'i përdorur dhe zgjidhur problemet që jeta ofron", -deklaroi ministria Nikolla. Një grup mësuesish të trajnuar janë vetëm fillimi për ministrin e Arsimit pasi kjo teknologji kërkon mësues edhe më shumë të trajnuar që të jenë kudo në 12 qarqet e vendit për të pa-



sur mundësinë që fëmijët përmes njohurive të tyre të formojnë kompetencën por edhe të luftojnë lajmet e pavërteta dhe të pabazuar në studime shkencore mbi mjedisin, natyrën dhe ujin. Ambasadorja gjermane deklaroi nga shkolla "Gustav

Mayer" se ky laborator do ta bëjë më të kuptueshëm mjedisin jetësorë të nxënësve, të cilët do të ushtrohen në eksperimente të dobishme, por edhe argëtues për të kuptuar më shumë nga fenomenet që i rrethojnë.

Ministri i Turizmit dhe Mjedisit: Synojmë ekuilibër mes natyrës dhe ekonomisë

Vendimi: Ndalohet ndërtimi i HEC-eve në zonat e mbrojtura

Blendi Klosi: Nuk do të jepem më leje mjedisore

Ndërtimi i HEC-eve nuk do të lejohet më të kryhet në zonat e shpallura të mbrojtura. Ky vendim i prerë vjen nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, pas konstatimit të abuzimeve të shumta me lejet mjedisore. Ministri Blendi Klosi, në fjalën e tij ka bërë me dije se ky vendim synon të ndalojë ndërtimet në zonat me vlerë jo vetëm natyrore por edhe historike. "Ne kemi marrë një vendim, nëpërmjet ligjit të zonave të mbrojtura. Kështu në zonat e mbrojtura nuk do të ketë më leje për të dhënë një HEC. Kushdo ministër pas meje, do ta ketë pothuajse të pamundur e unë do të shprejsoja 100% të pamundur, që të japë leje mjedisore në një zonë që është e klasifikuar si një zonë e mbrojtur", -theksoi ministri Klosi. Synimi kryesor i ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit është vendosja e një ekuilibri mes zhvillimit ekonomik dhe ruajtjes së natyrës është. Ndërkohë kjo ministri ka ngritur një grup pune me ekspertë të fushës për vendosjen e rregullave të forta lidhur me ndërtimin e HEC-eve dhe mënyrën e shfrytëzimit të lumenjve pa sjellë dëme në mjedis. "Vendosja e këtij ekuilibri nuk do të thotë domosdoshmërisht refuzimin e njërës nga të dyja veprimtaritë. Ne duam që të kuptojmë qartë se cilat janë rregullat mbi të cilat shtu zhvillohet një aktivitet si aktiviteti i prodhimit të energjisë të natyrës", shtoi Klosi. Valbona, Osumi, Vjosa Bushtrica janë disa prej lumenjve me vlerë të mëdha mjedisore dhe turistike me të cilat është abuzuar ndër vite dhe që kërkojnë ndërhyrje emergjente për të ndaluar

VENDIMI

"Ne kemi marrë një vendim, nëpërmjet ligjit të zonave të mbrojtura. Kështu, në zonat e mbrojtura nuk do të ketë më leje për ndërtimin e HEC-eve. Kushdo ministër pas meje, do ta ketë pothuajse të pamundur e unë do të shprejsoja 100% të pamundur, që të japë leje mjedisore në një zonë që është e klasifikuar si një zonë e mbrojtur", - theksoi ministri Klosi.



Blendi Klosi, ministër i Turizmit dhe Mjedisit

pasojat. **EKSPERTËT** Disa kohë më parë, drejtori ekzekutiv i organizatës mjedisore Eco Albania, Olsi Nika ka thënë për "Gazeta Shqiptare" se numri i projekteve të hidrocentraleve që do të ndërtohen buzë lumenjve apo përrenjve, ka arritur në 540 në vendin tonë. "Sa i përket ndikimit të këtyre HEC-eve nuk mund të flitet në mënyrë përgjithëse por sidoqoftë një shifër prej 540 HEC-esh (ndoshta edhe më tepër në vitet e ardhshme), në një rrjet hidrografik prej rreth 3.000 km padryshim që është një ngarkesë e papërbalueshme. Megjithatë nga përvoja jonë e dërranishme si EcoAlbania, nuk është vetëm problemi i sasisë

shumë të madhe të projekteve të HEC-eve por edhe vendosja e tyre pa i marrë parasysh të gjitha konsekuencat e sidomos mënyra e ndërhyrjes si pjesë e procesit të zbatimit të këtyre projekteve. Mjafton të përmendim se vë Shqipëri rreth 39% e të gjithë HEC-eve janë planifikuar/ndërtuar apo janë në ndërtim në rrjetin e Zonave të Mbrojtura. Në këtë optikë ndikimi i HEC-eve në integritetin e këtyre zonave më ekuilibra mjaft të brishtë do të jetë në shumë raste i pakthyeshëm", thotë Nika. Më tej ai shton se pjesa më e madhe e këtyre HEC-eve janë shumë të vegjël dhe nëse do të ndërtohen kontributi i tyre në buxhetin e energjisë do të ishte jo më shumë se 10-15%, ndërkohë që gjurma e tyre ekologjike është aq e mad-

he sa nuk e justifikon sakrificën e natyrës për pak energji. "Sa i përket ndikimit të ekonomi, gjithashtu, kontributi është mjaft i vogël si nga prodhimi i energjisë ashtu edhe nga punësimi ndërkohë që orientimi drejt turizmit natyror do të ishte disa herë më i leverdishëm për politikën e zhvillimit dhe në respekt të natyrës", -theksoi eksperti.

he sa nuk e justifikon sakrificën e natyrës për pak energji. "Sa i përket ndikimit të ekonomi, gjithashtu, kontributi është mjaft i vogël si nga prodhimi i energjisë ashtu edhe nga punësimi ndërkohë që orientimi drejt turizmit natyror do të ishte disa herë më i leverdishëm për politikën e zhvillimit dhe në respekt të natyrës", -theksoi eksperti.

AKU sekuestron 552 kg mish të pacertifikuar në Elbasan

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit po vijon aksionin për identifikimin, kontrollin, evidencimin, dënimin dhe ndalimin e çdo veprimtarie të kundërligjshme e të rrezikshme nga subjektet që neglizhojnë apo shkelin rregullat e sigurisë ushqimore. DRAKU Elbasan gjatë kësaj jave ka kryer një sërë aksionesh gjatë të cilave ka konstatuar

shkelje të sigurisë ushqimore, për rrjedhojë janë vendosur gjithsej 8 gjopa në vlerën 1.800.000 lekë dhe u bllokuan 552 kg mish. Konkretisht, gjatë kontrollit të ushtruar në tregjet e Elbasanit u konstatuan dhe sekuestruar 18 kg peshk me destinacion asgjësimi dhe 40 kg mish dele pa vullë dhe certifikatë veterinare. Ndërsa,

Bashkia e Tiranës vijon ndërhyrjet e saj në të gjithë kryeqytetin për rehabilitimin e blloqeve të pallateve. Ndërmarrjet e Bashkisë po vijojnë me ritme të shpejta punën për rehabilitimin e sipërfaqes 1000m2 në bllokun e pallateve tek Rr. "Pandi Dardha". Deri më tani, falë kësaj ndërhyrje është bërë i mundur rikonstruksioni dhe sistemimi i të gjithë segmenteve rrugore dhe shesheve. Një kujdes i veçantë i është kushtuar dhe vendeve për kalimin e këmbësorëve në rrugë, për të mundësuar lëvizjen e lirshme të personave me aftësi të kufizuara, si dhe karrocave me fëmijë. Po kështu vëmendje i është kushtuar edhe ndërtimit të rrugicave pedonale mes shesheve, ndërsa Bashkia deklaron se po punon për vendparkimet e automjeteve, ndriçimin dhe për gjelbërimin e shesheve ndërmjet pallateve dhe vendosjen e stolave.



Bashkia e Tiranës, rehabilitim në bllokun e banimit në Lapranë

Studimi i organizatës "Qëndresa Qytetare"/ 7000 kuota të paplotësuara për 2018-2019

Voltiza Duro

Tkurren universitetet publike, mbyllen 41 programe studimi në vend

Xhemollari: Tarifat e larta e korrupsioni, faktorët kryesorë

Këtë vit të ri akademik, universitetet publike në vend do të hapin dyert për studentët me 41 degë studimi të mbyllura e me 7000 kuota të paplotësuara. Të dhënat alarmante që dëshmojnë qartë tkurrjen e universiteteve publike zbardhen nga studimi i organizatës "Qëndresa Qytetare" sipas së cilës në universitetin e Gjirokastrës do të mbyllen 13 degë, në atë të Elbasanit 12, në universitetin e Shkodrës do të mbyllen 6 degë dhe në universitetin e Korçës 7 të tilla. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", drejtori ekzekutiv i kësaj organizate tregon se shkaqet kryesore të mbylljes së 41 degëve në mbarë vendin janë tarifën e larta të studimit, përkëqësimi i situatës së arsimit të lartë në vend si dhe reformat e njëpasnjëshme që kanë shkaktuar kolaps. Rigels Xhemollari më tej thekson se sipas raporteve të mëparshme të "Qëndresës Qytetare" në lidhje me nivelin e perceptimit dhe pranisë së korrupsionit në universitete, tek ato universitete që niveli i korrupsionit është më i lartë janë mbyllur më shumë degë studimi.



Rigels Xhemollari

Sipas analizës që ka realizuar "Qëndresa Qytetare", sa është numri i degëve që do të mbyllen për vitin e ri akademik 2018-2019 dhe në cilat universitete?

Bazuar në të dhënat e portalit të krijuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për rankimin e maturantëve u-albania, aktualisht rezultojnë 41 programe studimi që për shkak të mungesës së studentëve të regjistruar shkëlqejnë drejt mbylljes. Në Universitetin e Gjirokastrës mbyllen 13 degë, në atë të Elbasanit 12, 6 në atë të Shkodrës dhe 7 degë në Universitetin e Korçës.

Cilat janë degët që do të mbyllen? Sa kuota kanë ngelur bosh në institucionet e arsimit të lartë publik në vend?

Për shkak të politikave të gabuara të ndjekura nga shteti ynë, po xhitet çdo ditë e më shumë emigrimi i të rinjve duke braktisur universitetet publike, duke ndaluar prej 6 vitesh me ligj doktoratit. Universiteti Egërem Çabej në Gjirokastrë nuk do të diplomojë më historianë, universiteti Luigj Gurakuqi nuk do të diplomojë më fizikanë. Për ironi të fatit edhe universiteti Aleksandër Xhuvani s'do të diplomojë më filozofë e ai i Vlorës nuk do të ofrojë më programe studimi për kiminë. Këtë vit të ri akademik, universitetet publike do të hapin dyert me 41 degë studimi të mbyllura në total dhe 7000 kuota të lira, kuota në dispozicion të studentëve shqiptarë në kërkim.

Sa është numri i degëve

KORRUPSIONI

"Tek ato universitete që niveli i korrupsionit është më i lartë janë mbyllur më shumë degë studimi. Ky fakt tregon se tregtimi i notës dhe diplomës si mall tregu ka prodhuar efektin e antireklamës të këto universitete", - bën me dije Xhemollari.

që rrezikojnë të mbyllen?

Përveç programeve të studimit që nuk plotësojnë numrin minimal të studentëve që është 10 studentë për program studimi, sipas analizës së "Qëndresës Qytetare", edhe 22 Programe të tjera rezultojnë me 12 - 13 studentë, të cilët për arsye emigracioni ose humbje të interesit apo për shkak të mos arrijtes së rezultateve të duhura nuk e kalojnë vitin akademik, do të çojnë në vazhdimin e tkurrjes së programeve të studimit duke i kthyer këto universitete në shkolla - koleje 2 - vjeçare.

Cilat janë arsyet kryesore që kanë ndikuar në mbylljen e 41 degëve?

Sipas analizës sonë arsyeja kryesore përse situata e arsimit të lartë është përkëqësuar duke mos u preferuar më nga të rinjtë shqiptarë është mungesa e trajtimit të arsimit si prioritet kombëtar duke investuar vetëm 3% të GDP dhe duke u rënditur të fundit në rajon sa i takon këtij treguesi. Ne me ligj kemi ndaluar shkencën duke bllokuar doktoratit për 6 vite, po me ligj po shkatërrojmë edhe universitetet. Pra, në vendin që ka më shumë nevojë për arsim dhe rritje të cilësisë së kapitalit human, investohet më pak.

Mendoni se tarifën e lartë faktor për tkurrjen e universiteteve publike?

Studentët shqiptarë paguajnë tarifën më të lartë në Europë të studimit për universitetet publike dhe marrin shërbimin më pak cilësor të mundshëm. Gjithashtu, vendi ynë edhe pse rezultojnë me pagat minimale dhe mesatare nga më të ulëtat, ju ofron atyre jetën studentore më të shtrenjtë në Rajon. Këtë fakt na e vërteton edhe raporti i Fondacionit Gjerman Friedrich Ebert "Pabarazia në Europën Juglindore" ku theksohet se vetëm 1% e të varfërve shqiptarë kanë akses në arsimin e lartë, ndryshe nga vendet e rajonit ku kjo shifër shkon deri në 11%. Ky fakt tregon se politikat tona sociale janë më të dobëta, pagat minimale 180 euro dhe mesatare 290 euro nuk arrijnë të përballojnë tarifa deri në 2500 euro, përpos jetesës, qirave dhe shpenjimeve të tjera që kanë studentët. Këto tarifa krahasuar me vendet e zhvilluara europiane janë absurde pasi po të marrim shembullin e Gjermanisë dhe Austrisë, ku pagat mesatare shkon deri në 2200 euro, tarifën e studimit janë 0-600 euro.

Po reformat e njëpasnjëshme në arsim si kanë

41

DEGË TË MBYLLURA

"Këtë vit të ri akademik, universitetet publike do të hapin dyert me 41 degë studimi të mbyllura në total dhe 7000 kuota të lira, kuota në dispozicion të studentëve shqiptarë në kërkim", - thekson drejtori ekzekutiv i organizatës "Qëndresa Qytetare".

UNIVERSITETI I DURRËSIT

10	Shkenca për Arsimin Filor	70	52	18
11	Shkenca Ekonomike	95	51	44
12	Mami	51	50	1
13	Misuri për Arsimin Parashkollor	35	50	5
14	Shkenca Publike	70	43	27
15	Marketingu në Publikun	70	42	28
16	Publike Ekonomike	70	41	29
17	Filozofia	48	39	9
18	Administrim Publik	70	38	31
19	Filozofi	50	37	13
20	Menastrim Hotelieror	70	37	33
21	Gjuhë Gjermane dhe Anglisht	45	36	9
22	Administrim Biznes	80	34	46
23	Menastrim - Marketing	80	34	46
24	Muhameda dhe Teozoria Djalit	65	34	31
25	Specializim (2- vjeçar)	43	31	12
26	Histori	70	28	42
27	Teknologji Automotivsh (2- vjeçar)	42	28	14
28	Asistenti Strategjiko (2- vjeçar)	44	27	17
29	Informatikë Anglisht	58	26	32
30	Menastrim Turizim Kultur	70	24	46
31	Matematikë Informatikë	100	23	77
32	Navigation dhe Menastrim Detar	38	23	15
33	Menastrim Ndërkombëtar (2- vjeçar)	43	20	23
34	Komunikim dhe Marketing Digital	50	20	30
35	Asistenti Legjislativ (2- vjeçar)	34	20	14
36	Asistenti Administrativ (2- vjeçar)	34	19	15
37	Menastrim Transporti (2- vjeçar)	43	19	24
38	Informatikë Publike (2- vjeçar)	33	18	15
39	Menastrim Turizim Arsimor	70	18	52
40	Historigrafia (2- vjeçar)	43	18	25
41	Specializim Komunikim (2- vjeçar)	33	13	20
42	Filozofi-Sociologji	59	12	47
43	Menastrim Biznes Program në Gjuhë Anglisht	29	10	18
44	Menastrim Historik Turizim (Program në Gjuhë Turke)	28	4	24
45	Menastrim Ndërkombëtar në Gjuhë dhe të mesazhe (Program në Gjuhë Anglisht)	25	4	21

PROGRAME STUDIIMI QË SHPËTOJNË

PROGRAME STUDIIMI QË NË RREZIK MBYLLEJE (4)

PROGRAME STUDIIMI QË MBYLLEN (2)

UNIVERSITETI I SHKODRËS

5	Infermier (Mam)	70	70	0
6	Edukim Fizik dhe Sport	70	70	0
7	Gjuhë Anglisht	70	50	20
8	Turizim	100	48	52
9	Informatikë	85	36	49
10	Punë Sociale	60	36	24
11	Infermier (Fizioterapi)	35	27	8
12	Misuri për Arsimin Parashkollor	60	24	36
13	Filozofi	60	21	39
14	Misuri për Arsimin Filor	60	20	40
15	Gazetar dhe Komunikim	73	18	55
16	Gjuhë -Letërsi	100	15	85
17	Matematikë	68	14	54
18	Biologji -Kim	80	14	66
19	Gjeografi	90	13	77
20	Gjuhë Gjermane	60	11	49
21	Gjuhë Italiane	60	8	52
22	Histori	85	6	79
23	Pedagogji muzikore	30	5	25
24	Gjuhë Frëngje	40	4	36
25	Pikturë e grafika	30	2	28
26	Fizikë	60	2	58

PROGRAME STUDIIMI QË SHPËTOJNË

PROGRAME STUDIIMI QË NË RREZIK MBYLLEJE (4)

PROGRAME STUDIIMI QË MBYLLEN (6)

UNIVERSITETI I KORÇËS

11	veçar "Shkrim Social"	49	22	27
12	Edukim për Inzhinierë dhe Injenerë s tërësorë	30	21	9
13	Teknologji Informacioni	35	20	15
14	Histori - Gjeografi	50	19	31
15	Program profesional 2- vjeçar "Menastrim Veterinar"	55	19	36
16	Program profesional 2- vjeçar "Menastrim Biznes Bujqësor"	55	19	36
17	Program profesional 2- vjeçar "Asistent Menastrim"	35	18	17
18	Program profesional 2- vjeçar "Mbrojtësia Zyre për Komunikim Statistikë dhe Aktiv"	35	17	18
19	Administrim Biznes në Turizim	80	16	64
20	Bachelor në "Informatikë Biznes"	80	14	66
21	Agronomi	50	13	37
22	Matematikë - Fizikë	35	13	22
23	Gjuhë Letërsi	50	11	39
24	Agronomi	50	11	39
25	Program Profesional 2- vjeçar "Tëknika të Prodhimit të Lëvës dhe Fibërës"	55	10	45
26	Ekonomikë	60	9	51
27	Inzhinieri Agronomikë	60	9	51
28	Bachelor në "Biznes dhe Mgr"	35	8	27
29	Filozofi-Sociologji	45	7	38
30	Mjekësi e Bimëve dhe Hortikulturë	40	5	35
31	Arsim parashkollor	20	3	17
32	Gjuhë dhe Kulturë Frëngje	30	2	28

PROGRAME STUDIIMI QË SHPËTOJNË

PROGRAME STUDIIMI QË NË RREZIK MBYLLEJE (5)

PROGRAME STUDIIMI QË MBYLLEN (7)

ndikuar?

Në Shqipëri prej 2006-s, çdo vit ndryshon rruga e maturantëve për në universitet, njëherë fuqizohet mesatarja e më pas provimet, apo matura njëherë bëhet hyrëse e më pas dalëse, kjo situatë krijon kolaps dhe cenim të sistemit meritë preferencë, gjë që ka shtyrë maturantët e këtij viti të zgjedhin universitetet perëndimor për të studiuar. Pas çdo reforme të pasuksesshme shteti ynë ka ndërmarrë një tjetër po të pasuksesshme pa analizuar efektet e së parës.

A ka korrupsion në universitetet publike?

Sipas raporteve të mëparshme të "Qëndresës Qytetare" në lidhje me nivelin e perceptimit dhe pranisë së korrupsionit në universitetet, tek ato universitetet që niveli i korrupsionit është më i lartë janë mbyllur më shumë degë studimi. Ky fakt tregon se tregtimi i notës dhe diplomës si mall tregu ka prodhuar efektin e antireklamës tek këto universitete.

Sipas jush si mund të parandalohet tkurrja e universitetit publik?

Në emër të Qëndresës dua t'i bëj thirrje të gjithë pedagogëve dhe studentëve të angazhohemi së bashku për të shpëtuar universitetin nga tkurrja dhe mbyllja e degëve të studimit. Vetëm qytetarët dhe banorët që popullojnë universitetin mund të ndryshojnë këtë situatë që do e quajmë anti - shkencë që ka kapluar çdo instancë që ka në objekt rregullimin e sistemit arsimor.

Anketa e Bankës së Shqipërisë për 6-mujorin e parë të 2018-ës

Xhepat e shqiptarëve bosh, rriten shpenzimet, jo buxheti

Përkeqësohen balancat mes të ardhurave dhe harxhimeve

Shpenzimet e familjeve shqiptare u rritën me ritme më të shpejta se të ardhurat në pjesën e parë të vitit 2018. Trendi i buxheteve familjeve u zbardh nga Banka e Shqipërisë, një anketë të posaçme për gjendjen financiare në 1140 njësi familjare. Banka e Shqipërisë vërejtë se niveli i përgjithshëm i të ardhurave dhe shpenzimeve të familjeve është rritur gjatë periudhës së vërtuar, por rritja e shpenzimeve ka qenë më e theksuar, duke rezultuar në ngushtim të balancës financiare (të ardhura-shpenzime) të familjeve. Në shpërndarjen e familjeve, sipas nivelit të shpenzimeve të domosdoshme të jetesës, pjesa më e madhe (rreth 50% e të përgjigurve) vijojnë të deklarojnë shpenzime mujore në nivelin 20-50 mijë lekë, dhe kjo peshë nuk ka ndryshuar krahasuar me 6-mujorin e kaluar, por krahasuar me një vit më parë. Nga ana tjetër, peshë e familjeve që deklarojnë shpenzime në nivele të larta (mbi 50 mijë lekë në muaj) ka vijuar të rritet, si në terma 6-mujorë edhe në terma vjetorë, ndërkohe që vihet re tendenca e kundërt në rastin e dy grupeve më të ulëta të shpenzimeve. Në përgjithësi, struktura e



Banka e Shqipërisë

shpërndarjes së familjeve sipas nivelit të shpenzimeve është zhvendosur drejt një niveli më të lartë shpenzimesh mujore. Banka e Sh-

qipërisë vërejtë se indeksi i të ardhurave dhe indeksi i shpenzimeve kanë shënuar rritje gjatë 6-mujorit të parë, por rritja e indeksit të shpen-

zimeve ka qenë më e theksuar, duke rezultuar në një përkeqësim të balancës midis të ardhurave dhe shpenzimeve të familjeve. Numri i familjeve që kanë deklaruar dhe burime të tjera të qëndrueshme të ardhurash (si qira, interesa bankare etj.) ka rënë në 10% të të përgjigurve, ose 112 familje. Në këtë grup, rreth 61% deklarojnë si burime alternative të ardhurash "interesa bankare nga kursimet" dhe 31% dek-

Niveli i përgjithshëm i të ardhurave dhe shpenzimeve të familjeve është rritur gjatë periudhës së vërtuar, por rritja e shpenzimeve ka qenë më e theksuar, duke rezultuar në ngushtim të balancës financiare (të ardhura-shpenzime) të familjeve.

larojnë të ardhura nga qiradhënia e pronave. Pjesa tjetër e familjeve deklarojnë kombinim të të dyjave ose burime të tjera të ardhurash. Eurozimi i të ardhurave të familjeve shqiptare vijon të mbetet i ulët, ku vetëm 14% e të përgjigurve (161 familje në 1140 familje të përgjigjura) deklarojnë se kanë të ardhura në valutë (kryesisht në euro), në raporte të ndryshme ndaj totalit të të ardhurave mujore. Kjo peshë ka mbetur e pandry-

shuar në tri vërtimet e fundit. Banka e Shqipërisë shpjegon se "Indeksi i të ardhurave" është ndërtuar si shumë e peshuar e frekuencave në % të përgjigjeve me koeficientet e përcaktuara për çdo interval si në vijim: 'deri në 17 mijë lekë' me 0.2; '17-50 mijë lekë' me 0.4; '50-100 mijë lekë' me 0.6; '100-200 mijë lekë' me 0.8 dhe 'mbi 200 mijë lekë' me 1. Vlerat e marra për çdo vit janë kthyer në indeks me bazë vitin 2010 = 100. Rritja e vlerës së indeksit nënkupton rritje të nivelit të të ardhurave mujore. Gjithashtu "Indeksi i shpenzimeve" është ndërtuar si shumë e peshuar e frekuencave në % të përgjigjeve me koeficientet e përcaktuara për çdo interval si në vijim: 'deri në 10 mijë lekë' me 0.2; '10-20 mijë lekë' me 0.4; '20-50 mijë lekë' me 0.6; '50-100 mijë lekë' me 0.8 dhe 'mbi 100 mijë lekë' me 1. Vlerat e marra për çdo vit janë kthyer në indeks me bazë vitin 2010 = 100. Rritja e vlerës së indeksit nënkupton rritje të nivelit të shpenzimeve të domosdoshme mujore. 6 alternativat e lidhura me nivelin e të ardhurave në monedha të huaja janë: (1) 'nuk kam fare', (2) 'deri në 10%', (3) '10-50%' dhe (4) 'mbi 50%'. "Monitor"

REQUEST FOR EXPRESSIONS OF INTEREST
(CONSULTING SERVICES – INDIVIDUAL SELECTION)

Second Multi-Donor Trust Fund for Capacity Building Support to the Implementation of the Integrated Planning System (IPS 2) Consulting Service For

Local Consultant
Communications Specialists to support Public Relations and Change Management activities

ALBANIA
Project: Second Multi-Donor Trust Fund for Capacity Building Support to the Implementation of the Integrated Planning System (IPS 2)
Project ID: P129332
Assignment Title: Communications Specialists to support Public Relations and Change Management activities
Ref. No: AL-IPS2-P129332-IC-CS-18-04-07

The Government of Albania has received financing from the World Bank toward the cost of the Second Multi-Donor Trust Fund for Capacity Building Support to the Implementation of the Integrated Planning System (IPS 2) Project.

The IPS 2 Project will support the Government of Albania in further strengthening the implementation of the Integrated Planning System (IPS), which links strategic policy planning with the budget planning and public financial management more broadly. Main beneficiaries of this project are the Ministry of Finance and Economy (MoFE) and the Department of Public Administration (DoPA) under the Prime Minister Office (PMO).

Due to the involvement of several key stakeholders and execution of a number of activities in parallel, there is a need for effective awareness and communication of IPS 2 ongoing activities, organization of joint events to share the developments and progress, develop a communication campaign to closely monitor and promote the achievements of project implementation. Additionally, the AFMIS, EAMIS and IPSIS project teams developed their change management plans, and a comprehensive communications strategy and action plan should be prepared and implemented to support these activities.

To support the change management and public relations for ongoing project activities, the MoFE will hire a local communications expert (further on referred to as the Consultant).

The main objective of this assignment is to assist the MoFE for the preparation, and implementation of an effective communication strategy, action plan and campaign related to integrated programmes and project activities and their impact on the life of Albanian citizens, as well as the public employees and government entities.

The Central Finance and Contracting Unit in the Ministry of Finance and Economy of Albania, invite eligible Consultants to indicate their interest in providing the Services.

Interested Consultants should provide information demonstrating that they have the required qualifications and relevant experience to perform the Services. The qualifications required are:

- Master degree in one of the following disciplines (e.g. journalism, public or international relations, marketing, communications, social sciences).
- Not less than 3 years of practical experience in developing Communication Strategy/Action Plans /PR Campaigns/Social Media products, or involved in communication/media projects related to public sector and/or private sector.
- Proven track record of providing effective communication and PR support to government entities for similar activities will be considered as an advantage.
- Excellent communication, monitoring, analytical and report writing skills.
- Working experience with EU and/or other Donors agencies is desirable.
- Fluency in both Albanian and English languages is required.

The attention of interested Consultants is drawn to paragraph 1.9 of the World Bank's Guidelines: Selection and Employment of Consultants under IBRD Loans and IDA Credits & Grants by World Bank Borrowers (January 2011 edition, revised July 2014) ("Consultant Guidelines"), setting forth the World Bank's policy on conflict of interest.

A Consultant will be selected in accordance with the Individual Consultants (IC) method set out in the Consultant Guidelines.

Further information can be obtained at the address below during office hours from 08:00 to 16:00, Mondays to Thursdays, and from 08:00 to 14:00 on Fridays.

The service will be selected under the provisions of the World Bank's Guidelines for the Selection and Employment of Consultants, dated January 2011, revised July 2014, based on the method of Selection of Individual Consultants (IC), Time Based Contract.

The complete Terms of Reference is posted on the website of CFUCU: <http://cfucu.financa.gov.al>

Expressions of interest (CV, Cover letter and documentary evidence for fulfilling the qualifications) must be delivered in a written form to the address below in person, or by mail, or by fax, or by e-mail within October 23rd, 2018, local time 12:00.

Mrs. Enkelejdja Kokthi, General Director
Central Finance and Contracting Unit (CFUCU)
Ministry of Finance and Economy
enkelejdja.kokthi@financa.gov.al
cfucu.financa.gov.al
Deshmoret e Kombit Blvd. No.3, Tirana, Albania
Tel: + 355 4 24 51 180

Vlera totale e investimit, 3.9 miliardë lekë

Unaza e Madhe e Tiranës, ARSH shpall kompanitë që do e ndërtojnë

Me një vlerë totale prej 3.9 miliardë lekësh, Autoriteti Rrugor Shqiptar ka shpallur kompanitë fituese që do të kryejnë punimet në lotin 2 dhe 3 të Unazës Lindore të Tiranës. Investimi në lotin 2, që kap vlerën e 1.58 miliardë lekë parashikon ndërtimin dhe përfundimin e plotë të këtij aksi rrugor, duke siguruar lidhjen me segmentet rrugore të përfunduara dhe me ato që do të ndërtohen në vazhdim. Në këtë pjesë, projekti kalon nëpër Pleshën e Farkës, mbi pjesën e sipërme të përroit të Kabatit, duke dalë në zonën e Shkozës. Punimet në këtë aks do të kryhet nga bashkimi i operatorëve "Albavia& Geci", ndërkohe që afati i përfundimit është 24 muaj. Ndërkaq, sa i takon lotit 3, zonat kryesore që kufi-



zajnë këtë objekt janë ato që njihen me emrin zona e Shkozës, "Ali Demi" dhe "Kodra e Priftit". Objekti ka një gjatësi të përgjithshme rreth 3.3 kilometra dhe do të kushtojë 2.33 miliardë lekë. Ky segment është i ndarë në dy pjesë. Pjesa e parë është vazhdim i Unazës që vjen nga Farka dhe përfundon në jug të Ish-Uzinës së Autotraktorëve. Ndërsa pjesa e

dytë fillon pak mbi Maternitetin e Ri të Tiranës dhe duke ndjekur rrjedhën e sipërme të lumit Lanë, intersektion urën e Shkozës dhe përfundon në jug të Ish-Uzinës së Autotraktorëve, duke u lidhur me Unazën e Madhe të Tiranës. Edhe në këtë segment punimet do të zgjatën 24 muaj, ndërsa do të zbatohen nga kompani "Gjikuria".

Në bisedë kuptohet se kush është "bashkëpunëtori", por jo kush është "Agroni"

"Babalja", zbardhet aktekspertiza: Audiopërgjimi është i montuar

Regjistrimet e zërave nuk janë origjinale, ka prerje, mbivendosje, montazhe apo edhe ndërhyrje

TIRANË

Zbardhet aktekspertiza e përgjimit të prokurorisë për dosjen "Babalja", ku thuhet se audiopërgjimi i publikuar nga PD, që implikonte vëllain e Fatmir Xhafajt, Agron Xhafajn në pazare droge nuk është original, por i montuar. Në emërtimin audio-video thuhet se ka prerje, mbivendosje dhe montazhe apo edhe ndërhyrje. Nga ekspertiza rezultoi se: "Shumica e bisedës është midis 'Agronit' dhe bashkëpunëtorit, ka shenja që në sfond është edhe zëri i një burri të tretë. Regjistrimi nuk e përmban bisedën e plotë. Nuk ka hapje të bisedës apo përhëndetje, gjëra të cilat për dikë janë të pritshme, si fillim kur palët takohen".

Bazuar tek ekspertiza, në bisedën e parë kuptohet se kush është "bashkëpunëtori", pra zëri i Albert Veliut, por nuk arrihet të kuptohet zëri se kush është në të vërtetë "Agroni". Kjo, pasi zëri i Agron Xhafajt sipas ekspertizës është i një cilësie shumë të dobët. Në dokument thuhet se ekspertizës do t'i duhej një regjistrim i një cilësie më të mirë se të folurit të "Agronit" për të arritur në një konkluzion nëse është i Fredi Alizotit apo Agron Xhafajt.

AKTI I EKSPERTIMIT KA KONKLUDUAR

Regjistrimet nuk janë regjistrime origjinale. Regjistrimi video ishte marrë nga pamjet e videove. Ajo përbëhej nga dy video, shkirim dhe dy biseda të regjistruara. Këto dy biseda janë fokusit i analizës së ekspertit. Nuk ka qenë në gjendje të marrë regjistrimet origjinale të këtyre bisedave.

BISEDË E PARË: Biseda e parë ndodh në minutën 1 e 4 sekonda të kohës së videos dhe zgjat për 14 sekonda. Ajo duket të jetë një pjesë e një thirrjeje telefonike dhe folësit janë emërtuar: "bashkëpunëtori" dhe "Agroni". Megjithatë, vetëm e folura që i atribuohet bashkëpunëtorit është e dëgjueshme (e kapshme). Dhe për këtë arsye, ekspertiza ka ekzaminuar bashkëpunëtorin, por jo Agronin nga kjo bisedë.

BISEDË E DYTË: Regjistrimi i dytë, i cili është një bisedë e bërë ballë për ballë, ndodh në minutën 1 e 25 sekonda të kohës së videos. Ajo zgjat 1 minutë e 46 sekonda. Përsëri ajo është një bisedë midis burrit të quajtur "bashkëpunëtori" dhe "Agronit". Në këtë regjistrim e folura nga të dyja palët është e dëgjueshme. Ndërsa shumica e bisedës është midis "Agronit" dhe bashkëpunëtorit, ka shenja që në sfond është edhe zëri i një burri të tretë. Regjistrimi nuk e përmban bisedën e plotë. Nuk ka hapje të bisedës apo përhëndetje, gjëra të cilat për dikë janë të pritshme, si fillim kur palët takohen. Biseda vetë është shumë e shkurtër dhe gjithashtu shfaqen ndryshime shumë të papritura sa u takon temave të bisedës. Dy janë shpjegimet e mundshme:

A - Regjistrimi është në



Albert Veliu



Faksimile e aktekspertizës së audiopërgjimit

pjesë të mbledhura nga një regjistrim më i gjatë.

B - Vetëm një pjesë e bisedës është regjistruar.

Gjendet mbështetje e fortë në qëndrimin se folësi në fjalë i emëruar "bashkëpunëtori", në bisedën e parë është Albert Veliu.

Gjendet mbështetje e fortë e moderuar në qëndrimin se folësi në fjalë i emëruar "bashkëpunëtori", në bisedën e dytë në fjalë është Albert Veliu.

Gjendet mbështetje e fortë se folësi në fjalë, i emëruar "Agroni", në bisedën e dytë në fjalë nuk është Agron Hyseni.

Vërehen ndryshime të

rëndësishme forensike midis zërit të Agronit dhe atij të zotit Hyseni.

Kampioni i bisedës në regjistrimin Agroni në bisedën e dytë, objekt ekspertimi, nuk është i përshatshëm për të arritur në konkluzion (pozitiv ose negativ) lidhur me zotërinë Alizotit dhe Xhafaj.

Kampioni i ligjëratës në "Agroni" nuk është i mjaftueshëm për të arritur në konkluzion (pozitiv ose negativ) lidhur me zotërinjtë Alizotit dhe Xhafaj.

Kampioni "Agroni" është i një cilësie shumë të dobët. Arsyeja pse ekspertiza ishte në gjendje të arrinte në një

konkluzion negativ për zotin Hyseni në lidhje me atë, lidhej me faktin se ai dhe "Agroni" kishin shumë dukshëm zëra të ndryshëm. Ekspertes do i duhej një regjistrim i një cilësie më të mirë të të folurës së "Agronit" për të arritur në një konkluzion lidhur me zotërinjtë Alizotit dhe Xhafaj.

KËRKESA E PROKURORISË

Gjashtë muaj pas publikimit të një përgjimi të bisedës së pretenduar mes Agron Xhafajt, vëllai i ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj dhe Albert Veliut, Prokuroria për Krime të Rënda firmosi dje arrestin për të njohurim me nofken "Ba-

bale". Ndaj Veliut, që u identifikua në krye të herës edhe si "dëshmitari X", rëndojnë dyshimet për akuzat e kallëzimit të rremë kryer në bashkëpunim dhe kalimit të paligjshëm të kufirit, pasi pas publikimit të audiopërgjimit, ai u largua nga Shqipëria në Kosovë përmes kufirit të gjelbër. "Babale" ndodhet në Kosovë dhe urdhri pritet të ekzekutohet nga autoritetet atje. Në pranga është vënë edhe kunati i "Babales", Fred Alizoti nga Fieri, pasi ka dyshime se imitoi zërin e Agron Xhafajt gjatë bisedës me Veliun. Për gazetarin Jetmir Oldashi, që realizoi intervistën me "Babalen" është caktuar nga gjykata masa e arrestit me burg. Publikimi i audiopërgjimit trazoi politikën shqiptare dhe jo vetëm, pasi pretendohet se vëllai i ministrit të Brendshëm dyshohet për përfshirje në pazare droge. Audiopërgjimi u dërgua për ekspertizë në Romë, e kur autoritetet italiane refuzuan ekspertizën, u përçoll për në Britaninë e Madhe. Autoritetet e huaja sollën pak ditë më parë ekspertizën, nga e cila rezultoi se ishte një material i montuar, por nuk jepte mundësi për të identifikuar zërat e personave që bisedonin në njëri-tjetrin. Pas administrimit të ekspertizës, prokuroria thirri në pyetje deputetin demokrat, Ervin Salinji. Prokuroria konfirmoi për "News 24" se vijon ende hetimet për të zbuluar nëse ka persona të tjerë të përfshirë në këtë çështje.

Sherr me armë në Cërrik, plagosen 2 persona

CËRRIK - Dy persona kanë mbetur të plagosur pasditën e djeshme në Cërrik. Ngjarja ndodhi rreth orës 18:00, në vendin e quajtur "Kryqëzimi i Yllit". Burime zyrtare nga policia bënë me dije se është plagosur me armë zjarri në këmbë shtetasi me inicialet G.K., 20 vjeç, banues në fshatin Malasen, si dhe shtetasi J.R., 22 vjeç, banues në Cërrik. Vj të fundit ka marrë plagë të lehta në dorë, ndërsa të dy ndodhen në spitalin kirurgjik të Elbasanit jashtë rrezikut për jetën. Nga veprimet e shpejta të policisë dhe grupit hetimor, dyshohet se shtetasi me inicialet B.H., së bashku me shtetasin I.F. po udhëtonin me një automjet tip "Golf" që drejtohej nga shtetasi Angelo Zhelegu. Burimet policore thanë se shtetasi B.H. ka parë shtetasin me inicialet G.K., me të cilin kishte një konflikt të mëparshëm për motive të dobëta që ka zbritur nga automjeti dhe është konfliktuar fizikisht me të. Në konflikt është përfshirë edhe shtetasi J.R., shoku G.K., si dhe dy shokët e B.H., shtetasit A.Zh dhe I.F. Në konflikt e sipër dyshohet se shtetasi B.H. ka qëlluar me pistoletë në drejtim të G.K., i cili është plagosur në këmbë, si dhe është plagosur në dorë shoku i tij me inicialet J.R.. Policia ka kapur dhe shoqëruar në komisarjat drejtuesin e mjetit, Angjelo Zhelegu, i cili ka larguar nga vendngjarja autorin e dyshuar dhe shokun e tij. Forca të shumta të policisë të DVP Elbasan janë vënë në ndjekje të autorit dhe bashkëpunëtorit tjetër. Grupi hetimor po vijon punën për zbardhjen dhe dokumentimin e plotë të kësaj ngjarjeje.

KPK: Bëri deklaram të rremë, fshehu pasurinë

I shtet makinat më shtrenjtë se sa i blen, gjyqtarja e Korçës rrezikon detyrën

TIRANË - Kryetarja e Gjykatës së Apelit Civil në Korçë, Entela Prifti rrezikon shkarkimin nga detyra për shkak të pasurisë. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka zhvilluar dhe seancën dëgjimore për Priftin. Trupa gjyquese përbëhet nga Firdes Shuli, Roland Ilija dhe Etleda Çiftja. Sipas raportit të ILDK-PI-së, të lexuar në seancë rezultoi se gjyqtarja Entela Prifti ka të ardhura nga shita e makinave. KPK deklaroi se Prifti i shtet disa herë më

shkurtër makina të cilat janë blerë me shumicë të shtrenjtë se sa çmimi i blerjes dhe çmimet nuk reflektojnë me tregun. Një tjetër problematikë sipas KPK-së, ka qenë mosdeklarimi i transfertave në llogarinë e së motrës. Ndaj, KPK theksoi se gjyqtarja Prifti ka disa pasuri dhe llogari të padeklaruar. Entela Prifti ushtron prej 10 vitesh detyrën e kryetares së Gjykatës së Apelit të Korçës, që pas emërimit të saj në vitin 2008. Më parë, ajo ka ushtruar detyrën e gjyqtares pranë

shtrenjtë makina të cilat janë blerë me shumicë të shtrenjtë se sa çmimi i blerjes dhe çmimet nuk reflektojnë me tregun. Një tjetër problematikë sipas KPK-së, ka qenë mosdeklarimi i transfertave në llogarinë e së motrës. Ndaj, KPK theksoi se gjyqtarja Prifti ka disa pasuri dhe llogari të padeklaruar. Entela Prifti ushtron prej 10 vitesh detyrën e kryetares së Gjykatës së Apelit të Korçës, që pas emërimit të saj në vitin 2008. Më parë, ajo ka ushtruar detyrën e gjyqtares pranë



Gjyqtarja Entela Prifti para KPK-së

së njëjtës gjykatë. Në vitin 2011, Entela Prifti ka qenë anëtare e Kolegjit Zgjedhor. Paralelisht me detyrën, ajo ka ushtruar gjithashtu mesimdhenie në universitetin "Kristal" në Korçë për

një periudhë disave vjeçare. Analiza e pasurisë është një ndër tri shtyllat e rivlerësimit për gjyqtarët, së bashku me kontrollin e figurës dhe vlerësimit e aftësive profesionale.

VRASJA NE BLOK HISTORIA

Pas plagosjes në lokalin në zonën e ish-Bllokut, Ervis Martinaj ka mohuar se ishte planifikuar një përplasje apo një sherr me armë mes dy grupeve. Në dëshminë e tij të siguruar nga Lapsi.al, Martinaj ka sqaruar se kishte shkuar në lokal për t'u sqaruar me Matajn, jo për t'u përplasur. Madje Martinaj thotë se ka tentuar ta shmangë sherrin, duke vënë në dukje se komando Mervjol Billo nëse do të kishte dashur, mund ta kishte vrarë.

"Unë e njihja prej kohësh si Komandon, ashtu edhe Matën. S'kemi pasur konflikte me njëri-tjetrin. Nuk shkua për t'u vrarë, por për t'u sqaruar. Nëse do donin të më vrisnin, unë do isha i vdekur sot. Pasi u plagosa pa dashje në qafë dhe truprojet e mi u vranë. Por komando nuk qëlloi mbi mua. Edhe pse unë isha i shtrirë. Plumbi më kapi padashje. Sherri nuk ka ndodhur për asnjë femër, sepse nuk vuaj unë për to që të shkoj të vritem për ato", mësohet se ka thënë Martinaj.

Lapsi.al mësoi se në dosjen e prokurorisë janë regjistruar 11 persona të përfshirë në sherr: 5 prej tyre kanë qenë në tavolinë me Ervi Matën, kurse 6 me Martinajn. Ende hetuesit nuk kanë mundur t'i identifikojnë të gjithë personat që kanë marrë pjesë në sherr, për shkak të mungesës së pamjeve filmike në lokalin ku ndodhi vrasja e Fabian Gaxhajt.

Mësohet se Martinaj i ka rrefyer prokurorëve se Gaxhajt kishte nxjerrë probleme edhe herë tjetër për shkak të temperamentit të tij. Një nga personat që përshkruan edhe

Dëshmia e të plagosurit për përplasjen me armë në zonën e ish-Bllokut

Ervis Martinaj: Nuk u bë sherr për femër, shkova të sqaroheshim

"Pistoleta i shkrepri Gaxhës pa dashje në ajër"



Ervis Martinaj

pronari i lokalit, që hynë më vonë në lokal dhe nisën të qëllonjë mbi Mervjol Billo është ende i paidentifikuar nga policia.

Martinaj ka treguar në prokurori edhe pse kishte qëndruar larg grupit të Matajt, megjithëse kishin lënë

takim bashkë për t'u sqaruar.

"Pse s'u ulëm në një tavolinë ku Mata kishte 1 orë e gjysmë që më priste? Sepse unë u ula në banak, kështu e kemi kodin tonë. Dhe jemi grric me sy, dy truprojet e mi me komandon. Më pas, vjen

PALET E PERFESHIRA NE SHERR

Të plagosur, nën arrest

1. Ervis Martinaj, 36 vjeç, banues në Tiranë
2. Eijon Hate, 28 vjeç, banues në Shkodër

I vrarë

➤ Fabian Gaxha, 28 vjeç

Në kërkim nga policia

1. Ervin Mata, 31 vjeç, banues në Tiranë
2. Fabio Allushi, 42 vjeç, banues në Tiranë
3. Mervjol Bilo, 41 vjeç, banues në Tiranë

Gaxha me një tjetër roje dhe godasin me qytën e pistoletës komandon.

Pasi u bëj me shenjë "çohuni dhe lëreni", Gaxhës i shkrepri pistoleta pa dashje në ajër; këtu ndërhyri komando që i vret", ka thënë Martinaj.

Pra, sipas Martinajt, parvarësisht tensionit që ekzistonte mes dy grupeve, shkak për degradimin e situatës dhe

vrasjes është bërë ndërhyrja e menjëhershme e Fabian Gaxhajt dhe e një personi tjetër që kanë qëlluar komandon Mervjol Billo dhe më pas shkrepja e armës pa dashje nga Gaxhajt.

Pikërisht në këtë moment, komando ka reaguar duke qëlluar për vdekje Gaxhajt dhe duke plagosur rëndë truprojet tjetër të Ervis Martinajt dhe vetë atë.

PAS NGJARJES



Merren në pyetje familjarët e këngëtares Elvana Gjata

Policia ka shoqëruar familjarët e këngëtares së njohur Elvana Gjata. Gazetaria Klodiana Lala raportoi për "BW" se familjarët u morën në pyetje në ambientet e policisë. Dyshohet se këngëtarja shumë e njohur dhe e dashur për publikun shqiptar ka qenë shkak i sherrit që solli një të vrarë dhe dy të plagosur mbrëmë në Bllok. Këngëtarja ishte në shoqërimin e të dashurit të saj, një biznesmen i njohur kur disa persona, miq të Ervis Martinajt e kanë ngacmuar duke provokuar sherrin dhe më pas palët kanë nxjerrë armët duke sjellë kasaphanën që ndodhi. Familjarët kanë dhënë në polici dëshminë, ndërsa burimet pohuan se këngëtarja ndodhej në gjendje të rënduar psikologjike.

"Konflikt për t'u sqaruar në lidhje me ngacimin e Elvana Gjatës"

Rrëfimi i dëshmitarit, Redi Popesku: Si nisi sherri mes palëve në lokalin tim

Redi Popesku, pronari i lokalit në zonën e ish-Bllokut natën e së enjtes, tregoi në prokurori se si nisi konflikti mes dy grupeve, të Ervin Matës dhe të Ervis Martinajt, që përfundoi me një të vrarë dhe dy të plagosur.

"Lapsi.al" disponon dëshminë e plotë të Popeskut, ku tregohet dëshmia dhe jepet një version i motivit të ngjarjes, sipas të cilit shkak janë bërë ngacimet e Elvana Gjatës. Vetë këngëtarja ka qenë para lokalit pak para se të ndodhte përplasia me armë dhe është takuar aty me të dashurin e saj Ervin Matën dhe truprojet e saj, komandon Mervjol Billo.

"Ngaqë u krijua rrëmujë



e madhe unë kam dëgjuar një krismë, që erdhi nga vendi ku ishte personi i giatë me kapuç në kokë, që po konfliktohej me Jolin, por që nuk e pashë se kush qëlloi. Mbas

kësaj krisme unë jam hedhur direkt poshtë banakut. Në këtë kohë kam dëgjuar krismat e armëve që vazhdonin. Kur krismat e armëve pushuan ka ardhur

Vis Martinaj zvarrë, të cilin e pashë se ishte plagosur në qafë dhe e kam marrë e kam zbritur poshtë të shkallët. Kur kam ikur të gjithë personat kishin ikur veç atij që ishte vrarë dhe një tjetri që përpëlitej i plagosur", dëshmon ai.

"Me sa kuptova unë ky ka qenë një konflikt ordiner për t'u sqaruar në lidhje me ngacimin e të dashurës së Ervin Matës, shtetasen Elvana Gjata"

"Pasi kanë mbaruar të shtënat unë kam qenë i shtrirë poshtë banakut. Tek vendi ku isha unë i shtrirë ka ardhur Ervis Martinaj pranë meje dhe ishte i shtrirë dhe po më thoshte: Më çohuni në spital! Unë e pashë që po i dilte gjak nga qafa. Jemi ngritur të dy. Ervisi mbahej nga krahu im, e kam shoqëruar deri tek fundi i shkallëve dhe i kam thënë që merr një taksì. Ervisi iku në drejtim të lokalit KFC dhe më pas nuk e pashë.

Personazhet që u qëndruan larg rrjeteve sociale në ditët e lumtura

Ja kush janë fëmijët "sekretë" të VIP-ave

Prirja për t'u vendosur bebeve emra shqiptarë

Egla Xhemali

Erion Veliaj është bërë baba para disa ditësh. E gjithë vëmendja e publikut, duke e ditur me siguri që nuk do publikojë një foto të djalit që sapo ka ardhur në jetë është që të mësojë emrin e bebit. Nisur nga kjo po rendisim më poshtë të gjithë bebet VIP, që deri më sot askush nuk ka arritur t'ua zbulojë imazhin.



Amarda Toska

Çifti i famshëm i skenës shqiptare, Ermal Mamaqi dhe Amarda Toska u bënë disa muaj më parë prindër të një vajze. Përmes një postimi në rrjetet sociale, Mamaqi ka njoftuar ardhjen në jetë të Sias. As ata nuk i shpëtuan tendencës së VIP-ave që nuk duan të shfaqin imazhin e fëmijës që sapo ka lindur. Më e kujdesshme natyrisht që ishte Ami. Ditë më vonë pasi çifti ndau me fansat lajmin e bukur, Ermali përsëri postoi foto me Amin që ishte pranë karrocës së të bijës. Edhe këtë herë ata e mbajtën larg botës virale vogëlushen e tyre.



Erjon Veliaj

Kryetari i Bashkisë së Tiranës është bërë për herë të parë baba. Bashkëshortja e tij, Ajola Xoxa ka sjellë në jetë disa ditë më parë një vogëlush, që rrëmbu vëmendjen e gjithë mediave. Çifti nuk publikoi asnjë foto të bebes së sapolindur, duke i lënë njerëzit në kuriozitet për të zbuluar fytyrën e vogëlushit. Erion Veliaj ndau një detaj për median. Fëmija i tyre do të ketë emër shqiptarë. Pak muaj më parë kryebashkiaku shprehej me gjithë emocion për ditët e pritjes së të birit. "Më ka transformuar. Sot, kur po vija në punë, tek sheshi 'Wilson' ku po bëhen disa punime për uljen e trotuarit, po thosha me vete 'karroca kalon këtu?' Kam filluar të vë re shumë gjëra të vogla që ndoshta i vinin re vetëm ata me fëmijë. Kështu që, si Erion, besoj se fëmija do të më bëjë njeri më të mirë".

Arbana Osmani

Prezantuesja më e dashur për publikun, Arbana Osmani është bërë nënë tri vite më parë. Ajo u mundua t'u qëndronte larg rrjeteve sociale duke u shkëputur për një kohë relativisht të gjatë prej tyre. Mirëpo, Osmani ditën e ardhjes në jetë të fëmijës publikoi gjininë e tij dhe emrin që kishte menduar së bashku me bashkëshortin. Njerëzit i patën sytë tek ajo se mos ndoshta do e shuante vetë moderatorja kureshtjen që kishin për pamjen e të voglit. Natyrisht që Arbana nuk ua plotësoi këtë dëshirë të gjithë atyre që mezi e prisnin foton e birit të saj, Jonit. Edhe sot që djali i saj është rritur, ajo preferon ta mbajë sa më larg ekspozimeve në rrjet.



Edi Rama

Kryeministri Edi Rama e ka përjetuar me shumë emocion ardhjen në jetë të djalit të vogël. Me anë të një postimi në rrjetin social "Twitter", Rama bëri të ditur se bashkëshortja e tij, Linda, sollti në jetë fëmijën e tyre të parë, Zahon. Kureshtja e njerëzve për të parë të birin e kryeministrit ishte e madhe. As ai nuk ra 'pre' e ndarjes së fotove të djalit në rrjetet sociale. Kemi parë që Rama është mjaft i lidhur me djalin e tij të vogël. Para disa kohësh ai ka postuar në "Instagram" një foto, në të cilën ishte duke luajtur me të me top. Ndërkaq, ende nuk janë shfaqur imazhe nga afër të djalit të kryeministrit.

Rudina Magjistari

Për të ka qenë momenti më i bukur në jetë kur lindi vajza e saj. Moderatorja e emisionit të pasdites në TV "Klan", edhe pse i ndau momentet e para të ardhjes së vajzës në rrjetet sociale, u tregua mjaft e kujdesshme që asnjë foto e bebes të mos publikohej. Nëpërmjet një statusi në "Facebook", ajo përshkroi gjithë lumturinë e të qenurit nënë e re. Edhe Magjistari i qëndroi larg botës virale, pastaj u rikthye sërish në televizion. Mia tanimë është rritur, megjithatë mami i saj nuk ka aspak dëshirë të publikojë foto nga afër të së bijës.




Tuna dhe Vildane Zeneli, me skena të nxehta në shtrat

Këngëtarja e njohur Tuna Sejdi do të sjellë së shpejti bashkëpunimin e saj me artistin shqiptar nga Nju Jorku, Seven Saraçin. "Maria" mban titullin kënga e tyre më e re, e cila është punuar nga vetë Seven Saraçi në studion e tij. Klipi i këngës "Maria" pritet të jetë mjaft "i nxehtë", pasi pjesë e tij do të jetë edhe një prej modeleve më të njohur shqiptare, Vildane Zeneli. Bukuroshja ka ndarë me fansat në rrjetin social "Instagram" trailerin e klipit, në të cilin do të shfaqet në skena mjaft provokuese me Tunën. Nuk kanë qenë të pakta komentet e fansave të saj, ku më së shumti Zeneli ka marrë komplimente..



Klea Huta poston foton intime me Elgitin

Ata janë kthyer ndër çiftet më të ëmbël të "showbiz"-it dhe ndër më të komentuarit. Edhe pse për shumë kohë e mbajtën të fshehtë lidhjen e tyre, që nga momenti kur dolën publikisht së bashku, Klea dhe Elgiti tani duket se nuk dinë të ndalen me postimet e ëmbla për njëri-tjetrin. Së fundmi, Klea ka postuar një "story" në "Instagram" në shtrat me Elgitin, i cili duket se është duke fjetur gjumë. Mbi foto ajo ka vendosur këngën e famshme, kolonën zanore të shumë çifteve "A te" të këngëtarit të madh Xhovanoti.



Armina Mevlani, më provokuese se kurrë

Blogerja e njohur Armina Mevlani ka publikuar në rrjetet sociale një foto e saj ku ka treguar se sa në formë dhe seksi shkon ajo në punë. Me fund të shkurtër dhe me mjaft stil, ajo ka treguar një alternativë mjaft të bukur për të rendur drejt zyrës. Armina ka qenë në qendër të komenteve të ndjekësve në rrjetet sociale për fotot provokuese që ndan me ta.



Sekretari i Përgjithshëm i Aleancës: Të gatshëm ta pranojmë si anëtare në NATO

Marrëveshja me Greqinë, Stoltenberg: S'ka plan B për Maqedoninë

"Duhet të shfrytëzojnë këtë moment historik"

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg tha se nuk ka plan B për Maqedoninë, sepse vendi tani ka mundësinë që ndodh njëherë në jetë dhe se mund të bëhet anëtare e NATO-s vetëm nëse e pranon marrëveshjen me Greqinë. "Besoj fuqishëm se ajo të cilën duhet ta bëjë vendi tani është që të sjellë vendime për hapat e mëtejshëm. Qeveria dhe Kuvendi duhet t'i sjellin këto vendime. Të vendosin, se si do të shkojnë përpara, si të reagojnë për referendumin dhe të gjitha pasojat dhe implikimet politike të cilat i sollin ai", deklaroi Stoltenberg, i cili sot është për vizitë në Serbi. Sekretari i përgjithshëm i NATO-s theksoi se nëse institucionet demokratike në Shkup vendosin që ta zbatojnë në tërësi marrëveshjen me Greqinë, atëherë NATO-ja është e gatshme që shpejt ta pranojë Maqedoninë si anëtare e saj të 30-të. "Mundet që shpejt të fillojmë me nënshkrimin e protokollit për anëtarësim, shumë shpejt pas ndryshimit të emrit. U mbetet institucioneve të zgjedhura demokratike në Maqedoni se a do ta pranojnë dhe do ta zbatojnë marrëveshjen për emrin. Ne jemi të gatshëm që ta pranojmë Maqedoninë si anëtare të re", theksoi Stoltenberg. Përsëriti se nuk ekziston plan B ose alternativë tjetër për anëtarësimin e Maqedonisë përveç zbatimit të marrëveshjes me Greqinë. "Nuk ka anëtarësim pa marrëveshjen për emrin. Mënyra e vetme për anëtarësim është që vendi të merret vesh me Greqinë rreth kontestit për emrin. Për këtë ne e përsëritim marrëveshjen ndërmjet dy vendeve"-deklaroi Stoltenberg. Sekretari i përgjithshëm i NATO-s thotë se Aleanca nuk do t'i bëjë presion Maqedonisë që të sjellë vendime, sepse bëhet fjalë për vendime sovraane të një vendi sovran. "Por kjo është mundësi që ndodh një herë në jetë. E kanë mundësinë dhe duhet ta shfrytëzojnë këtë moment historik", porositi Stoltenberg. Ndërsa para disa ditësh, partia Bashkimi Demokratik për Integritet në mbledhjen e mbajtur ka shqyrtuar gjendjen aktuale të krijuar pas realizimit të referendomit konsultativ për hyrje të Republikës së Maqedonisë në BE dhe NATO me pranim të Marrëveshjes së Prespës. Partia e Ali Ahmetit ka vlerësuar se për momentin prioritet i vendit mbetet implementimi i Marrëveshjes së Prespës, ndërsa sa u përket zgjedhjeve të parakohshme, vlerëson se për momentin nuk është koha për zgjedhje, sepse sipas BDI-së mund të "rënohet" dinamika e implementimit të Marrëveshjes së Prespës, e cila mund të sjellë një situatë bllokuese të proceseve të vendit në strukturat euro-atlantike. Gjithashtu, edhe zëdhënësi i qeverisë greke, Dimitris Canakopoulos



Sekretari i përgjithshëm i Natos, Jens Stolten

JENS STOLTENBERG

"Mundet që të fillojmë me nënshkrimin e protokollit për anëtarësim, shumë shpejt pas ndryshimit të emrit. U mbetet institucioneve të zgjedhura demokratike në Maqedoni se a do ta pranojnë dhe do ta zbatojnë marrëveshjen për emrin. Ne jemi të gatshëm që ta pranojmë Maqedoninë si anëtare të re", - theksoi Stoltenberg.

REAGIMI I GREQISË

"Kryeministri Zoran Zaev ka fuqi politike dhe shumë opsione për t'i zbatuar ndryshimet kushtetuese. Athina po ndjek me vëmendje të posaçme periudhën kohore të zbatimit të obligimeve nga ana e Shkupit, më pas Marrëveshja e Prespës do të duhet të ratifikohet në Kuvendin e Athinës", - ka thënë zëdhënësi i qeverisë greke.

tha se kryeministri Zoran Zaev ka fuqi politike dhe shumë opsione për t'i zbatuar ndryshimet kushtetuese, por pa zbuluar se çfarë opsionesh nënkuptonte. Canakopoulos ka shtuar se Athina po ndjek me vëmendje të posaçme periudhën kohore të zbatimit të obligimeve nga ana e Shkupit, më pas çka Marrëveshja e Prespës do të duhet të ratifikohet në Kuvendin e Athinës. Deputeti i Syrizas, Kostas Duzinas ka theksuar se referendumi i mbajtur në IRJM nuk ka qenë i parashikuar me Marrëveshjen e Prespës, por ndryshimet kushtetuese me çka do të tejkalohen papërgjegjshmëritë e mbetura. Duzinas ndër tjerash akuzoi "Demokracinë e Re" opozitare se kundërshton marrëveshjen, për shkak se sipas tij nuk dëshiron zgjidhje të problemit të emrit dhe nuk i intereson interesi kombëtar. Ndërkohë Zv/Ministria e Rendit Publik dhe Mbrojtjes së qytetarëve, Katerina Papakosta tha se do ta mbështesë marrëveshjen nëse kjo është në interes kombëtar. Papakosta, e cila paraprakisht ishte anëtare e "Demokracisë së Re" mohoi se është bërë pjesë e qeverisë vetëm që të votojë "pro" marrëveshjes. Kështu që mbetet të shihet vendimi që do të merret në Kuvend lidhur me marrëveshjen e Prespës dhe anëtarësimin të Maqedonisë në NATO.



KOSTAS DUZINAS

Deputeti i Syrizas, Kostas Duzinas ka theksuar se referendumi i mbajtur në IRJM nuk ka qenë i parashikuar me Marrëveshjen e Prespës, por ndryshimet kushtetuese me çka do të tejkalohen papërgjegjshmëritë e mbetura. Duzinas ndër tjerash akuzoi "Demokracinë e Re" opozitare se kundërshton marrëveshjen, për shkak se sipas tij, nuk dëshiron zgjidhje të problemit të emrit dhe nuk i intereson interesi kombëtar.

U përtshi në afëra tenderësh, Jankullovska akuzohet për shpërdorim detyre

Bleu një makinë të blinduar për Gruevskin, dënohet me 6 vjet burg ish-ministria maqedonase



Gordana Jankullovska, ish-ministria e Punëve të Brendshme të Maqedonisë

AKUZAT

"Ish-ministria akuzohet për shkelje të procedurës së blerjes së një makine të blinduar për ish-Kryeministrin e Maqedonisë, Nikolla Gruevski, në vlerë prej 600 mijë eurosh".

prishje të procedurave të tenderit. Nga hetimet rezultoi se ish-kryeministri e paracaktoi personalisht automjetin, duke shkelur procedurat e përzgjedhjes me tenderim, e duke i shkelur shtetit dëm të konsiderueshëm ekonomik. Jankullovska ishte mes emrave të procesit gjyqësor "Tank" që përfshinte të gjithë të akuzuarit për këtë çështje. Por ajo u gjykuar në mënyrë të veçantë për shkak të shtatzënisë. Pak ditë më parë, Gjykata e Apelit la në fuqi vendimin për Gruevskin, i cili në maj u dënua me 2 vite e gjysmë burg. Gjykatësja tha se aspektet teknike të tenderit kanë favorizuar një kompani, ndërsa janë kërkuar edhe

kushte të tjera të posaçme, me çka është përjashtuar mundësia e subjekteve tjera për të marrë pjesë në tender. Për të njëjtin rast, me 2 vjet burgim është dënuar edhe Gruevski, ndërsa me 4.5 vjet Gjoko Popovski, ish-zyrtar i lartë në Ministrinë e Brendshme. Skandali është zbuluar nga afëra e përgjimeve që ishte publikuar nga opozita në shkurt të vitit 2015, ndërsa rasti është proceduar nga Prokuroria Speciale e Maqedonisë, e cila është themeluar për hetimin e shpërdorimeve të qeverisë së kaluar. Akuzat janë hedhur poshtë nga zyrtarët e dënuar duke i vlerësuar ato si "të motivuara politikisht". Jankullovska vazhdimisht ka qenë në shënjestër të kritikave, në veçanti të opinionit shqiptar, për shkak të ofendimeve në adresë të shqiptarëve, të cilët në disa raste i ka quajtur "indianë".

Vuçiq: Apel autoriteteve për kapjen e sulmuesve, janë shtetas serbë

Flisnin shqip në Serbi, rrihen barbarisht dy shqiptarë

19-vjeçarët në gjendje të rëndë, në kërkim autorët

Dy shqiptarë janë goditur barbarisht mbremjen midis të shtunës dhe të dielës në një rrugë në Novi Sad, ndërsa gjendja shëndetësore e njërit prej tyre është e rëndë. Siç raportojnë mediat kosovare, të rinjtë janë goditur për shkak se ata flisnin në gjuhën shqipe nga një grup prej katër vetash. Policia ka njoftuar se dy të rinjtë e dhunuar janë G.B dhe C.M të lindur në vitin 1999. Për këtë ka reaguar edhe Shoqata e Shqiptarëve me seli në Novi Sad dhe ka kërkuar që fajtorët të nxirren para drejtësisë. Shoqata njofton se i riu me inicialet C.M është në rrezik për jetën pasi ka marrë dëmtime në eshtrat e kokës dhe ka pësuar gjakderdhje në tru. I riu i është nënshtruar një operacioni. Në një bisedë për 'Gazeta Metro', ka folur Demë Berisha, shef i Zyrës së Bashkësisë Shqiptare në Serbi, me seli në Novi Sad. Berisha ka thënë për 'Gazeta Metro', se dy të rinjtë që janë shtetas të Kosovës, hasjanë nga Prizreni, kishin shkuar në Serbi për të punuar. Sipas Berishës, 19 - vjeçari, i cili ka marrë lëndime të rënda në tru, kishte vetëm dy ditë sa kishte shkuar në Novi Sad. Ai ka thënë ta ketë vizituar personalisht në spital viktimën, dhe siç i kanë thënë mjekët, djali që ka marrë lëndime të rënda, i është nënshtruar një operacioni në kokë, operacioni, i cili ka kaluar mirë, por ende nuk dihet nëse ai do të shpëtojë pa pasojë, pasi ende është në gjumë, që ia kanë shkaktuar mjekët për nevojat e tyre të mjekimit. Berisha ka bërë të ditur për 'Gazeta Metro', se sulmi ndaj të rinjve ka ndodhur të shtunën rreth orës 3:00 të mëngjesit, derisa të rinjtë nga Kosova po ktheheshin në banesën e tyre. Ata sipas tij, janë sulmuar vetëm pse ishin dëgjuar duke folur shqip.



Çlirim Maloku, njëri prej djemve të rrahur

DEMË BERISHA

Berisha ka bërë të ditur për 'Gazeta Metro', se sulmi ndaj të rinjve ka ndodhur të shtunën rreth orës 3:00 të mëngjesit, ndërsa të rinjtë nga Kosova po ktheheshin në banesën e tyre. Ata sipas tij, janë sulmuar vetëm pse ishin dëgjuar duke folur shqip.

ALEKSANDAR VUÇIQ

"Ne apelojmë tek autoritetet kompetente për t'i ndaluar dhe identifikuar sulmuesit sa më shpejt që të jetë e mundur. Të rinjtë sulmuar janë shtetas serbë. Unë jam duke i kërkuar MUP-it që të gjejë sulmuesit. Të gjithë qytetarët tanë duhet të kenë të njëjtën mbrojtje. Ata që mendojnë se mund të sillen ndryshe, do të gjejnë një përgjigje shumë të fortë nga shteti", - tha Vuçiq.

ka thënë se nuk dëshiron të tregojë emrat e viktimeve, pasi kështu kanë kërkuar familjarët e tyre nga Prizreni. Ai ka bërë të ditur vetëm inicialet, dhe moshën e tyre. Ata janë G.B dhe Ç.M, të lindur më 1999. Ndërkohë që siç raportojnë mediat serbe,

njëri prej të rinjve i është nënshtruar një operacioni të vështirë, pasi sipas mjekëve, një nga dy shqiptarët e dhunuar ka pësuar çarje në pjesën e kafkës. Për këtë ngjarje të rëndë ka reaguar edhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, i cili ka theksuar se dhunuesit do të vihen para drejtësisë. Sipas tij, të gjithë qytetarët që jetojnë në Serbi, pa asnjë dallim, do të trajtohet të barabartë, përcjell "24sata.hr". "Falënderojmë mjekët dhe ekipin e ndihmës së shpejtë. Ne apelojmë tek autoritetet kompetente për t'i ndaluar dhe identifikuar sulmuesit sa më shpejt që të jetë e mundur. Të rinjtë sulmuar janë shtetas serbë. Unë jam duke i kërkuar MUP-it që të gjejë sulmuesit. Të gjithë qytetarët tanë duhet të kenë të njëjtën mbrojtje. Ata që mendojnë se mund të sillen ndryshe do të gjejnë një përgjigje shumë të fortë nga shteti", -tha Vuçiq. Ndërkaq policia po punon intensivisht për zbardhjen e plotë të ngjarjes së rëndë.

Kryeministri kosovar: Ideja për shkëmbim territoresh ka 'vdekur'

Ramush Haradinaj shuan zërat: Pas dy muajve hiqen vizat, do mund të lëvizni të lirë

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj ka dhënë një afat rekord për liberalizimin e vizave, në replikë të zërave që thonë se vizat nuk liberalizohen para vitit 2020. Haradinaj ka reaguar ashpër ndaj atyre që thonë se vizat nuk liberalizohen deri në fillim të vitit 2020 ndërsa theksoi se vizat do të hiqen brenda këtyre muajve. Pasi takoi shkrimtaren Helena Kadare, kryeministri i Kosovës tha se deri në fund të këtij viti kosovarët do të mund të lëvizin pa viza. Komisioni Evropian ka dhënë rekomandim pozitiv për liberalizimin e vizave për Kosovën. Ndërsa, gjatë muajit shtator Parlamenti Evropian ka votuar pro lirisë së lëvizjes së qytetarëve të Kosovës. Në dhjetor të këtij viti pritet që Këshilli i Ministrave të japë vlerësimin mbilateralizimin e vizave. Ndërkaq kryeministri i Kosovës, ka deklaruar se



Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj

ideja për shkëmbim apo ndarje të territoreve mes Kosovës dhe Serbisë ka vdekur, ndërsa ka kërkuar që rezoluta e propozuar nga partitë opozitare të votohet në Kuvend. Këto komente Haradinaj i bëri pas ceremonisë së dekorimit me Hartën e Artë të Kosovës për shkrimtaren Helena Kadare, të cilës i shprehu falënderime për kontributin e dhënë për letërsinë dhe njohjen e shqiptarëve në botë. Sipas tij kjo rezolutë i detyron të gjithë, përfshirë edhe presidentin. "Rezoluta është një qëllim tani që na detyron të gjithëve, besoj edhe presidentin e vendit, pra nëse kjo rezolutë do të aprovohej në parlament shihet qartë në bazë të rezolutës së kujt i besohen të drejtat dhe për çfarë", -tha ai.

SHKURT

Thaçi: Kryeministri të korrigojë veten, se mund të ndërrohet

Në një deklaratë për mediat, presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi iu kundërpërgjigj kryeministrit Haradinaj pas komenteve të këtij të fundit për idenë e ndryshimit të kufijve me Serbinë. Presidenti Thaçi, që thyen rekord në përdorimin e fjalës "korrigjim", tha se edhe kryeministri Haradinaj duhet të korrigojë deklaratat e tij. "Jam i sigurt se kryeministri ka nevojë t'i korrigojë deklaratat dhe qëndrimet e tij rreth dialogut, pa dialog nuk ka të ardhme atlantike për Kosovën", -tha presidenti në konferencën e mbajtur. Thaçi



Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi

tha se kryeministri duhet të korrigojë, në të kundërt ata që nuk korrigojnë, ndërrohen. "Nuk jemi të përhershëm në pozicionet tona, kryeministrat dhe presidentet mund të ndërrohen, shkojnë e vijnë, gjithsesi mund të ndërrohen ata që nuk korrigojnë", -tha Thaçi.

SHKRIMTARET DIKTATURA

Së shpejti libri më i ri, "Shkrimtarët dhe artistët nën diktatin komunist", i gazetarit dhe studiuesit të njohur, Dashnor Kaloçi

Ekskluzive / Zbulohet korrespondenca e Ramiz Alisë dhe Hysni Kapos

Romani i Petro Markos: Enver Hoxha me 20 napolona ndau një vajzë nga i fejuari

Zv.ministri Mantho Bala: Autori ka bërë autolëvdata, ndërsa figurën e shokut Enver nuk e paraqet drejtë

Nga Dashnor Kaloçi

Trajtimi i figurës së Enver Hoxhës në një veprë letrare apo dhe në artet figurative nga ana e shkrimtarëve dhe artistëve gjatë periudhës së regjimit komunist të para viteve '90-të, ishte një problem me mjaft zarar dhe paraqiste një risk të madh për autorët që merrnin përsipër trajtimin e "figurës së udhëheqësit kryesor", si domos kur ai ishte në epiqendër të veprës si personazh kryesor i saj. Risku që mbartnin mbi vete krijuarit në rast të mos aprovimit të veprës, e cila trajtonte "figurën e udhëheqësit", nuk dëmtonte vetëm autorin e veprës, por edhe redaktorët, recensentët apo drejtuesit e Shtëpisë Botuese dhe ata të Lidhjes së Shkrimtarëve e Artistëve që kishin dhënë aprovimin për botimin e saj. Sidoqoftë kësaj, atë "risk" e patën marrë përsipër dhe provuar një numër jo i pakët shkrimtarësh e artistësh, por jo të gjithë arritën ta kalonin me sukses "provën e zjarrit" mbi të cilën endej e ravijëzohej "figura dhe roli i udhëheqësit kryesor" në fantazinë e tyre krijuese. Ndër të parët që e pësoi këtë gjë, ishte dhe shkrimtari i njohur Petro Marko, i cili që në vitin 1972-73, në romanin e tij me temë historike, "Një emër në katër rrugë", (i cili u konsiderua si "roman autobiografik"), merrte përsipër e trajtonte edhe figurën e Enver Hoxhës, kryesisht për periudhën e Monarkisë së Zogut. Madje duke e trajtuar atë gati-gati si personazh kryesor të veprës së tij, e cila jo vetëm që nuk u lejua të qarkullonte pas botimit të saj nga ana e Shtëpisë Botuese "Naim Frashëri", por ajo shkaktoi një furtunë të vërtetë për të gjithë ata që lejuan botimin e saj. Dhe e gjitha kjo, pasi në veprën e tij, Petro Marko "nuk kishte trajtuar drejt figurën dhe rolin e Enver Hoxhës"! Siç duket, fati i keq vazhdon ta ndiqte "këmba-këmbës" Petro Markon, (në vitet e para të pas Luftës, vuajti disa vjet burg politik), pasi botimi i librit të tij coincidoi edhe me fillimin e pranverës së vitit 1973, kur Enver Hoxha ndërmoi "furtunën" e madhe ndaj shkrimtarëve dhe artistëve, ku autori me origjinë nga Bregu, u ndodh papritur në qendër të atij "cikloni", madje krejt i zbuluar. Të gjitha këto dukën dhe nga këto dokumente arkivore që publikohen për herë të parë dhe të plota në faqet e këtij libri,



ku krerët më të lartë të udhëheqjes, duke filluar nga Ramiz Alia, Hysni Kapo, Manush Myftiu, Mantho Bala etj., kanë bërë një sërë shënimesh mbi to, duke dhënë orientimet përkatëse për dënimin e autorit Petro Marko, si dhe atyre që kishin lejuar e dhënë viston për botimin e atij libri, si: Pipi Mitrojorgji Ali Abdihoxa, Alqi Kristo, Dilaver Dilaveri, Dhurata Xoxe, Dalan Shaplo etj. etj. Aq i madh ka qenë alarmi i shkaktuar nga ai roman, sa që Ramiz Alia si rrallë ndonjë herë në të gjitha dokumentet që ai ka parë dhe nënshkruar, ka mbushur disa faqe të tëra me shkrimin e tij për ndëshkimin e atyre që lejuan botimin e tij, (gjë e cila duket dhe nga faksimilet përkatëse që po i publikojmë në këtë shkrim, ekskluziv për "Gazeta Shqiptare"), libër, i cili pa dritën e

botimit vetëm pas shembjes së regjimit komunist pas viteve '90-të.

LETRA E ZV/MINISTRIT MANTHO BALA PËR PROBLEMET QE NXORRI ROMANI I PETRO MARKOS

RELACION MBI ROMANIN E PETRO MARKOS "NJË EMËR NË KATËR RRUËGË"

Romani ka ardhur në shtëpinë Botuese "Naim Frashëri" në shtator të vitit 1972. Në muajin tetor-nëntor 1972 është recensuar nga Dalan Shaplo dhe Dilaver Dilaveri. Redaktor i veprës është caktuar Llazar Siliqi, i cili ka punuar nga dhjetori i vitit 1972 e deri në maj të vitit 1973. Në qershor 1973 e ka pasur redaksia, ndërsa autori e ka mbajtur për ripunim deri nga gjysma e korrikut të këtij viti dhe në 15

gusht vepra është dërguar në shtyp.

Mbasi e lexuam dhe diskutuam romanin, arritëm në konkluzionin se ai nuk duhet të qarkullojë për këto arsye:

1. Regjimi i Zogut nuk pasqyrohet me forcën e duhur në aspektin e tij klasik. Duke u marrë me shumë me shthurjen morale dhe injorancën që i karakterizonte njerzit në shërbim të këtij regjimi, autori ka lënë thuajse jashtë këndit të vështrimit tërë veprimtarinë politike të këtij mbreti satrap.

2. Tërë romani përshkohet nga shthurja e degjenerimi moral, nga skena e përshkrime erotike dhe banalitet që do të ndikonin negativisht të lexuesit ynë. Në mënyrë krejt të shtrembër paraqitet femra shqiptare. Del sikur ajo që në takimin e parë me mashkullin mendon vetëm për dashuri, bile në këtë drejtim tregohet e guximshme e inisiatore, gjë që nuk i përgjigjet realitetit. Duke spekuluar mbi pasqyrimin e shthurjes morale të regjimit në fuqi, autori nuk ka ruajtur sensin e masës dhe të krijon përshypjen sikur këto fenomene ishin të përhapura gjërë në vëndin tonë, çka nuk është e vërtetë.

3. Figura e shokut Enver nuk paraqitet drejt, saktë e gjërë. Bile ka episode të tilla ku veprimtaria e tij reduktohet në dhënieën e 20 napolonave për të shprehur një vajzë (Qazimen) nga i fejuari i saj, të cilën ajo nuk e donte. Dhe kjo ndodhi në një kohë kur dihet se shoku Enver përballonte probleme shumë të rëndësishme që kishin të




bënin me fatin e Atdheut dhe të revolucionit.

4. Disa personazhe nuk i trajton drejt. Kështu mund të përmendim Rizon. Duke theksuar injorancën e tij, të lokalizuar "nga një fshat i Kurveleshit", pavarësisht nga qëllimi që i ka vënë vetes autori, konfirmim propagandën e magali-idesë së shqiptarëve injorantë, të egër etj. Kjo figurë negative nga Kurveleshi, e paraqitur pa ndonjë personazh pozitiv po nga kjo krahinë e Labërisë që t'i kundërvihet, nuk tingëllon mirë.

Demiri (nga Peqini) për lexuesin tonë nuk mbetet figurë e krijuar, por historike dhe prandaj, ashtu si trajtohet, nuk duhet të zërë vënd në veprat tona.

Edhe figura të tjera të fshatit Dhrimadhe, sado që duken të krijuara, veçanërisht për lexuesin e asaj krahinë njihen, prandaj paraqitja e tyre në mënyrë të pasaktë historikisht nuk është e drejtë.

5. Romani ka pasaktësira historike edhe sa i përket vendosjes së së ngjarjeve në Dhrimadhe. Për lexuesin shqiptar është e qartë se këtu kemi të bëjmë me Dhërmium. Por ta paraqesësh atë si një qendër të lëvizjes revolucionare në bregdet, kur dihet se s'ka qenë e tillë, do të thotë të shtrembërosh realitetin historik.



Petro Marko



tin Zog dhe njerzit në shërbim të këtij rrethi. Janë lënë thuajse jashtë këndit të vështrimit veprimtarja e tij politike, figura e tij si shtypës, shfrytëzues dhe sundimtari më i egër e më i shëmtuar i historisë së popullit tonë.

4. Në roman ka shumë skena licencioze, episode të përshkrimi erotik dhe banale të tipit Dekameron, të krijuara nën ndikimin direkt të veprave të autorëve të huaj, që ndikojnë negativisht tek lexuesi ynë.

Përgjegjësia e shokut Ali Abdi-hoxha, Dhurata Xoxe dhe Llazaz Siliqi është veçanërisht e madhe po të mbahet parasysh se shqyrtimi i veprave dhe aprovimi për botim i saj, është bërë pikërisht në kohën kur zhvillohet debati i madh ideologjik për luftën kundra ndikimeve dhe shfaqjeve të huaja në letërsi dhe arte, kur organizatat e partisë dhe institucionet e kulturës dhe arteve ishin angazhuar në diskutime të gjalla kundër tyre. Shoku Ali dhe shoqja Dhurata nuk zbatuan me rigorozitet ndaj kësaj vepre, porosinë e dhënë për rishikimin e gjithë veprave që ndodheshin në redaksi ose në shtypshkronjë, nën drektim e fjalimeve të shokut Enver dhe më vonë në Pleniumin e 4-të të Komitetit Qëndror të PPSH-së. Ata vepuruan gjithashtu në kundërshtim me porosinë e dhënë nga shoku Ramiz në muajin maj të këtij viti, sipas së cilës nuk duhej të botohej asnjë veper letrare dhe jo letrare që merren në trajtimin në çfarëdo mënyre e shkallë të figurës së shokut Enver pa marrë më parë pëlqimin e aparatit të Komitetit Qëndror të PPSH-së.

Edhe në botimin e kësaj vepre shoqja Dhurata dhe shoku Ali kanë praktikuar metoda që nxisin dhe ushqejnë subjektivizmin në vler-simin e veprave. Kështu vepra "Një emër në katër rrugë", ju dha për redaktim Llazaz Siliqi të mbështetje të kërkesës personale të autorit.

SI KONKULZION:

1. Për dobësitë serioze ideore që u përmendën më lart, romani "Një emër në katër rrugë", të mos qarkullojë.



2. Brenda këtij muaji në bazë të udhëzimeve të K.P. të rrethit Tiranë, organizata bazë e partisë e Shtëpisë Botuese "Naim Frashëri" do të analizojë thellë këtë fakt, do të nxjerrë shkaqet, do të përcaktojë përgjegjësitë dhe masat që duhen marrë. Organizata bazë e partisë e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve do të analizojë përgjegjësinë e shokut Llazaz Siliqi si redaktor i veprës. Në mënyrë të veçantë do të analizohet fakti që ai gjatë redaktimit nuk morri në konsideratë disa vërejtje të drejta të karakterit parimor që kishin bërë recenzentët dhe e ka marrë për redaktim veprën në rrugë jo të drejtë, sipas kërkesës personale të Petro Markos. Do t'i hiqet vëmendje shokut Dalan Shaplo, i cili si recenzent i veprës ka dhënë aprovimin për botimin e saj dhe e ka çmuar atë si veper pozitive me vlera artistike.

3. Pavarësisht nga mendimi i organizatës, për arsyet që thamë më lart dhe për faktin se shoku Ali Abdi-hoxha nuk ka nxjerrë akoma konkluzionet e nevojshme nga kritikët që i janë bërë si drejtues i Shtëpisë Botuese "Naim Frashëri", të shkarkohet nga funksioni i këshilltarit. Të zbatohet menjëherë vendimi i marrë për largimin e shoqes Dhurata Xoxe nga Shtëpia Botuese "Naim Frashëri".

4. T'i hiqet vëmendja Komitetit të Kulturës dhe Arteve, i cili nuk ka ushtruar kontrollin e nevojshëm në Shtëpinë Botuese "Naim Frashëri", për ruajtjen të pastërtisë ideologjike në botimin e veprave letrare.

5. Të ngarkohet shoku Mantho Bala të thërrasë autorin dhe ta vëjë në dijeni për arsyet e mosqarkullimit të veprës së tij.

Sektori i Shypit
8.III.1973
(vijon nesër)



tekstin e ripunimit nga ana e autorit.

Tiranë, më 4-XII-1973 ZV / MIN-ISTRI
(Mantho Bala)

RELACION
MBI ROMANIN "NJË EMËR NË
KATËR RRUGË"

Në bazë të porosisë sonë Ministria e Arsimit dhe e Kulturës shqyrtoi romanin "Një emër në katër rrugë", procedurën që është ndjekur për botimin e tij dhe arriti në konkluzionin që përfshihen në informacionin që bashkëngjijm. Në bashkohemi me konkluzionin e Ministrisë dhe shtojmë se:

1. Romani është një veper autobiografike. Vetë vepra në variantin e saj të parë mbante titullin "Gjikë Bua". Dimë nga ana tjetër se i jati i Petro Markos quhej Marko Bua. Figurë kryesore, hero i veprës, është Gjikë Bua, që personifikon autorin e veprës, Petro Marko. Kjo kuptohet lehtas nga lexuesi. Rreth Gjikë Bua shtjellohen të gjitha ngjarjet dhe episodet e romanit. Ai jepet si një nga figurat kryesore revolucionare, si figurë qëndrore në përhapjen e ideve komuniste. Rreth tij lëvizin të gjithë revolucionarët e tjerë të asaj kohe. Meritat dhe autolevdatat janë në atë shkallë që të ngjallin zemërim dhe neveritje, të bërë me paramendim, me qëllim që të mbulojë të kaluarën e tij dhe të krijoj tek lexuesit e rinj që nuk e njohin nëq adhurim për "veprimtarinë e shquar revolucionare të Petro Markos" (sic).

2. I përshkruar nga një subjektivizëm i shfrenuar romani shtrembëron të vërtetën historike lidhur me pasqyrimin e lëvizjes revolucionare dhe Luftën Nacional-çlirimtare. Veçanërisht dobët, skematike dhe pa dinjitet është trajtuar figura e dhe roli i shokut Enver.

3. Regjimi i Zogut nuk pasqyrohet në aspektin e tij klasor. Vihet theksi në shturrjen morale dhe injorancën që e karakterizonte Mbretëria dhe nuk u ndal seriozisht tek kjo veper, sidomos pas fjalimeve të shokut Enver dhe materialeve të Pleniumit të IV-të, kur ajo rishqyrtohet shumë vepra të tjera që kishin të shtypshkronjë apo në proces.


Përgjegjësia kryesore për botimin e kësaj vepre të gabuar bie mbi Drejtorin e Shtëpisë Botuese "Naim Frashëri", dhe personalisht mbi ish-drejtorin, Ali Abdi-hoxha dhe nëndrejtorin, Ali Kristo, të cilët janë kritikuar edhe më parë për praktika të tilla pune.

Përgjegjësi të rëndë kanë gjithashtu: redaksia me në krye Dhurata Xoxe, e cila nuk e vlersoi drejt shqyrtimin e romanit, as dhe disa vërejtje të recenzentëve: redaktori Llazaz Siliqi, i cili me përvojën dhe pjekurinë e tij në këtë fushë, nuk duhej të kish lejuar t'i kalonte një veper e tillë, mbi të cilën ai punoi një kohë të gjatë; recenzentët Dalan Shaplo dhe Dilaver Dilaveri, të cilët nuk u thelluan sa duhet në gabimet e veprës, por e quajtën atë "pozitive dhe me vlera edukative".

Për këto arsye u porosit Shtëpia Botuese "Naim Frashëri" të bëjë një analizë të thellë, të nxjerrë shkaqet, të përcaktojë përgjegjësitë dhe masat që duhen marrë.

Në mendojmë që Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve në bashkëpunim me Shtëpinë Botuese të organizojë një diskutim për romanin si edhe për dramën e të njëjtit autor "Niku i Martin Gjinit", botuar në "Nëndori" nr. 11.

Sipas marrëveshjes që kemi me entin botues "Rilindja" të Prishtinës, një kopje e botuar e këtij romani është dërguar në Kosovë në kohën kur ai u dërgua për botim në shtypshkronjë. Prandaj do të lidhemi në telefon me entin botues të "Rilindja" për t'ju kërkuar që të na kthejnë kopjen e romanit, nën pre-



Vënja e e emrave të krijuar e për më tepër me ngajshëmi si për disa personazhe ashtu dhe për vëndin, nuk mund ta justifikojë autorin, i cili njëjherë specifikkën e lexuesit dhe të vëndit tonë.

6. Duke u nisur nga fakti se lexuesi e ka të lehtë të kuptojë se, Gjikë Bua është vetë autori, roli që i atribuohet atij si përhapës i ideve komuniste dhe i lëvizjes nacional çlirimtare në bregdet, është aspak

i saktë, as për periudhën para formimit të Partisë dhe aq më pak pas saj. Në këtë vështrim, ne mendojmë se me elementët autobiografik është tepruar shumë, duke kaluar në autolevdatë të pamërituara.

Recenzentët, sidomos Dalan Shaplo, kanë ngritur disa probleme, por nuk i kanë shkuar deri në fund veprës. Kurse redaksia nuk e ka realizuar plotësisht as vërejtjet e recen-

EKSPOZITA



Felix Nadar

10.10.2018
18:00h

NADAR

Burri që fotografoi Bodlerin e Dymanë vjen në "Marub"

Fatmira Nikolli

Një fotografi e çmendur, e bukur, e kompozuar ndryshe, rrëfimtare, përmblendhëse. Një imazh që tregon një ngjarje të tërë a një histori më vete, një ndalesë në kohë që përcjell një mendim, fytyrën e një të njohuri e përmes saj shikimin e tij të tretur a vendosmërinë e tij.

Ekspozita "La norme et le caprice" (Mes rregullave dhe tekave) është hapur në Muzeun e Fotografisë "Jeu de Paume" me një seleksion prej mbi 200 imazhesh, 74 prej të cilave do të prezantohen në ekspozitën "Mes rregullave dhe tekave" që do të hapet në muzeun "Marubi".

"Nadar. Mes rregullave dhe tekave" e kuruar nga Michel Poivert sjell për herë të parë koleksionin e pasur francez të një kohe të artë. Studioja fotografike më prestigjioze e Francës të fundshekullit XIX dhe fillim shekullit XX vjen në Muzeun Marubi me një përzgjedhje unike imazhesh nga atelieri Nadar, që na tregon se si portreti klasik i «burrave të mëdhenj» të shekullit XIX, i shpikur nga Félix, i la vend suksesit të fotografisë së aktorëve të teatrit të fotografuar nga i biri Paul në fillim të shekullit XX. Tregu i portretit kalon nga kthjellësia në fantazi duke na rrëfyer zhvillimin e një shoqërie ku kodet e famës ndryshojnë.

Kjo ekspozitë vjen si një bashkëpunim me Muzeun e Fotografisë "Jeu de Paume" në Paris, Médiathèque de l'architecture et du patrimoine, Ministrinë e Kulturës të Shqipërisë dhe Francës me mbështetjen e Ambasadës së Francës në Tiranë.

FÉLIX E PAUL NADAR

Félix TOURNACHON (1820-1910), me pseudonimin "Nadar", ishte i biri i një tipografi nga Lioni. Që nga viti 1846 ai publikon karikatura në disa gazeta satirike dhe në 1854 realizon "Panthéon Nadar", një seri prej dy litografish gjigante me karikatura të famshme parisienne. Vitin më përpara, në 1853, Félix i jep leksione fotografie vëllait të tij Adrien në studion e mjeshtrit Gustave Le Gray. Dy vëllezërit prodhojnë një seri të "Figures d'expression de Charles Deburau en Pierrot" që ka shumë sukses në Ekspozitën Universale të 1855. Pas një grindjeje, Adrien që përdor pseudonimin "Nadar i ri", dëshiron të shkëputet nga i vëllai e të vazhdojë karrierën i vetëm, por Félix e hedh në gjyq për ekskluzivitetin e përdorimit të këtij pseudonimi dhe e fiton atë. Félix, i cili ka gjetur tek fotografia një fushë tjetër eksperimentimi, vazhdon në këtë drejtim. Mes miqve të tij radhiten figurat më në zë të asaj kohe si Baudelaire, Nerval, Dumas, Gautier, Rossini, Berlioz. Në vitin 1859, entuziazmi për "portretin si kartvizitë" shuhet pas formulës të depozituar nga Disdéri

Koleksioni i jashtëzakonshëm francez me 74 imazhe në muzeun shqiptar të imazhit



e kjo shënon edhe fundin e kësaj veprë artizanale. Si rrjedhojë e kësaj, në vazhdim Nadar do të merrej vetëm me aktivitetin e tij fotografik në studion e re të Boulevard des Capucines, atelieri i mëparshëm i Gustave Le Gray.

Nadar, që realizon akoma ndonjë portret si ata të Sarah Bernhardt apo George Sand, orientohet drejt zhvillimeve teknologjike, siç është balona me ajër të ngrohtë. Më 1858,

ai realizon pamjen e parë ajrore mbi Petit-Clamart, e fotografuar me dritë elektrike, duke vijuar më pas me katakombet (1862) dhe rrjetin e kanalizimeve të Parisit gjatë 1864-1865. Në 1886, së bashku me birin Paul, ai realizon, intervistën me Eugène Chevreul, me rastin e 100 vjetorit të kimistit të famshëm. Fotografitë e marra në këtë okazion publikohen në "Le Journal Illustré", shkëpusim prej La Médi-

athèque de l'architecture et du patrimoine dhe Encyclopaedia Britannica.

Kuratori i ekspozitës në materialin e përgatitur vëren se Paul NADAR (1856-1939), që një ndër figurat më të rëndësishme për fotografinë, mbetet akoma nën hijen e të atit Félix Nadar. I lindur më 8 shkurt 1856 në Paris, Paul angazhohet që në moshë shumë të re në studion fotografike të të atit. Shumë shpejt, ai apasionohet pas fotografisë e në moshën 18 vjeçare bëhet drejtori teknik dhe artistik i atelierit parizien. Pasi thyen rregullat e estetikës së kthjellësisë të të atit, Paul realizon një sërë portretesh me shumë artifice, siç janë ata të aktorëve në skenat e teatrit. Në 1885 shpales angazhimet e tija artistike duke u bërë anëtar i shoqërisë franceze të fotografisë. Me vendosmërinë për t'u bërë i pavarur, ai krijon Zyren e Përgjithshme të Fotografisë, e cila merret me «furnizimin e materialeve fotografike, me aparate të shpikura prej tyre» si Detektiv i Nadar në 1887 dhe letra albumine Nadar në 1889. Pas suksesit të aparatit të tij «Express-Detective Nadar» në ekspozitën universale të Parisit në 1889, ai ndërmerr një ekspeditë fotografike Turkestanin rus. Fotografitë e marra gjatë këtij udhëtimi të tij në Lindje përbëjnë një dëshmi të rëndësishme të veçantisë së këtij fotografi.

KURATORI

Michel POIVERT është profesor i historisë së artit bashkëkohor dhe fotografisë. Kërkimi i tij bën bashkë analizën vizuale të mediave dhe kritikën teorike. Ai është redaktor i revistës 'Etudes photographique'



La norme et le caprice

ku publikohen artikuj teorikë e studimorë mbi fotografimin, artin dhe media. I diplomuar në Universitetin e Bordeaux dhe Pantheon Sorbonne, është aktualisht drejtor i programit të doktoraturave në Departamentin e Historisë së Artit në Paris 1 Pantheon Sorbonne. Poivert ka qenë president i Shoqatës Franceze të Fotografisë (1995-2000) dhe administrator i Fondacionit Neuflyze-OBC për artet pamore. Si kritik, Poivert ka publikuar shumë artikuj e katalogë mbi artin bashkëkohor që nga vitet 1990. Ka qenë kurator i «Le Salon de photographie, le pictorialisme en Europe et aux Etats-Unis» musée Rodin (1993), «Un monde non-objectif en photographie», galeria Thessa Hérold në Paris (2003), «L'utopie photographique, 150 ans de la Société française de photographie», Maison Européenne de la photographie, Paris, 2004, Musée d'art contemporain de Lyon, Jeu de Paume, Paris; ekspozitë në Centre Georges Pompidou, «Nadar, la norme et le caprice» në Château de Tours, ekspozita kushtuar Gilles Caron (1939-1970) në Muzeun e Elysées në Lausanne (2012), «L'image au service de la révolution (2006), L'Art de la photographie des origines à nos jours (2007), Gilles Caron le conflit intérieur (2012), Brève Histoire de la Photographie (2015).

TAKIMI

“E lashë letërsinë duke besuar te letërsia e madhe e Kadaresë”

Fatmira Nikolli

E lashë letërsinë duke besuar te letërsia e madhe e Kadaresë... Momenti më i keq në jetën tonë ka qenë debati për poemën “Në mesditë” kur u mblodh byroja politike”. Helena Kadare është në “Sonder” në Prishtinë e ftuar të flasë për letërsinë e saj dhe jetën e saj pranë shkrimtarit Ismail Kadare. Ajo ka qenë për herë të parë Helena Kadare atje në një rrëfim për letërsinë dhe jetën si bashkëshorte e shkrimtarit të madh para lexuesit të Kosovës. E vënë përballë gazetareve Beti Njuma e Alda Bardhyli, ajo bëri një rrëfim të rrallë mbi udhëtimin e pazakontë të një gruaje në letërsi.

Në historinë e letërsisë shqipe Helena Kadare hyn tek femrat e para që botuan në një letërsi të dominuar nga burrat që në vitin 1970-të me romanin “Një lindje e vështirë”. Libri u prit mirë nga kritika. Më pas ajo rikthehet për lexuesin në fillim të viteve ‘90-të me romanin “Një grua nga Tirana”, “Bashkëshortët” në vitin 2002. Me një stil të veçantë rrëfimet e Helenës janë përshkrur nga një ndjeshmëri i hollë.

Në Prishtinë tregoi se “në Kosovë kam qenë për herë të parë në një delegacion të Lidhjes së Shkrimtarëve të kryesuar nga Dritëro Agolli. Një vit më pas erdha me Ismailin. Kur erdha me të, vaska e hotelit ishte e mbushur me lule nga adhuruesit e tij, megjithatë më thanë se në Hotel Grand kishte përgjues”, kujton ajo vite më pas.

Helena ka një kontribut të konsiderueshëm në fushën e përkthimeve, mjaft të kujtomjëm për shembull “Tri gratë” e japonezit Isushi Inoe apo “Një grua në Berlin” ditar i një autoreje anonime, gjermane, që përshkruan javët nga 20 prilli deri në 22 qershor



Helena Kadare rrëfhet në Prishtinë dhe dekorohet me medalje presidenciale



1945. “Libri i parë që kam lexuar është një libër i vjetër me tregime, përsëri i shtëpisë vajzërore në Kala. “Kallëzime të çuditshme” e kishte emrin. Me autor Edgar Poe-n. Kam përshtypjen se më shumë se përmbajtja e këtyre tregimeve, ka qenë titulli që ka tërhequr vëmendjen time. Në

mënyrë të veçantë ajo fjala “të çuditshme” edhe pse, me sa më kujtohet, nuk kuptova shumë gjëra prej tij. Ndoshta ishte një libër i parakohshëm për moshën që kisha”, ka rrëfyer ajo më 2015.

Vitet e fundit ajo botoi librin autobiografik “Kohë e pamjaltueshme” ku tregon jetën e saj përkrah shkrimtarit Ismail Kadare. Udhëtimi i saj me “Letërsia dhe qyteti” drejt Prishtinës ishte një ngjarje për jetën kulturore, pasi sipas nuk ishte thjesht një rrëfim, por dhe një reflektim mbi mënyrën sesi kulturat sot ndërveprojnë me njëra-tjetrën dhe cili është roli i letërsisë sot në zhvillimet social-politike. Gjatë qëndrimit në Kosovë, Helena pati dhe një takim me studentët të Universitetit të Filozofisë.

DEKORIMI

Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, sot e ka dekoruar shkrimtaren e njohur

Helena Kadare me Medaljen Presidenciale të Meritave. Thaçi është shprehur se në kujtimet dhe publicistikën e shkrimtares Helena Kadare, vend të veçantë zë edhe dashuria ndaj Kosovës. “E dekorova shkrimtaren e njohur Helena Kadare për kontributin e saj autentik në pasurimin e letërsisë shqipe. Tek Helena Kadare, në kujtimet dhe publicistikën e saj, vend të veçantë zë edhe dashuria ndaj Kosovës”, u shpreh presidenti Thaçi. Ndërsa, shkrimtarja Helena Kadare e ka falënderuar presidentin Thaçi për dekoratën e ndarë dhe ka evokuar kujtime nga vizitat e saj të mëhershme. “Sa herë që vij në Kosovë, vërej përparim dhe i gëzohem çdo arritjeje të Kosovës”, ka thënë shkrimtarja Kadare. Presidenti Thaçi ka theksuar se fryma oksidentale e familjes Kadare është një vlerë e veçantë e kulturës sonë



Oskari dhe tezia Roze

Një pjesë psikologjike e shkruar nga Eric-Emmanuel Schmitt risjell në skenë aktoren e njohur Roza Anagnosti. Teatri Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli” ka zgjedhur si premierë për datat 13 dhe 14 tetor pjesën “Oskari dhe tezia Roze”. Oskar është një djal i vogël dhjetëvjeçar që jeton në spitalin e fëmijëve sepse vuan nga leucemia. As mjekët, as prindërit e tij nuk guxojnë t’i thonë të vërtetën mbi sëmundjen e tij. Por ja ku shfaqet teza Roza, në dukje një grua e ashpër, me karakter shpërthyes, por që fillon të bisedojë me të drejtpërdrejt. Për ta argëtuar pak Oskar, Roza i propozon një lojë: të sillje sikur çdo

“OSKARI DHE TEZJA ROZË” SJELL NË TEATËR ANAGNOSTIN

ditë e jetës së tij vlen të sa për 10 vjet. Në këtë mënyrë ajo i ofron mundësinë të jetojë gjithë jetën për disa ditë. Duke e përshpejtuar jetën e Oskarit, autori do të në bëjë të kuptojmë që nuk jemi të përjetshëm dhe duhet të meritojmë dhe gëzojmë çdo moment të jetës.

Tezia Rozë e këshillon, gjithashtu, t’i shkruajë Zotit, për t’u ndier më mirë. Edhe pse nuk beson vërtet në Zot, ai fillon t’i shkruajë letra dhe t’i kërkojë çdo ditë nga një dëshirë të plotësuar. Në letrat për

Zotin, Oskari flet edhe për dhimbjet, për prindërit, për shokët dhe shoqet në spital, për shqetësimet, gëzimet e tij, dashurinë e tij të parë, kohën që kalon...

Me dramatismin të Chris Simon-Mercurian, me përkthimin e Kopi Kycykut, regji të Kiço Londos, skenografi të Najson Topit, kostume të Klaudia Ndreshaj, shfaqja vjen me aktorët Roza Anagnosti, Franz Franc Bregu, Françeska Hysi, Juxhin Plovishi.

Opinion i Ditës

Rama qeveris, fajet i bën opozita!

Nga Andi Bushati

(vijon nga faqja 1)

... zë të ulur dhe me ton të sigurtë, nëse në Shqipëri rendi do të drejtohej keq, Saimir Tahiri nuk do të qe i pezulluar nga aktivitetet politike, Agron Xhafaj nuk do të vuante burgun në Itali dhe Rexhep Rahman Rahja nuk do të qe në qeli. Ky është virtyti i Rilindjes, ndërsa "llafollogjia e mejhaneve media-tike" dhe "lehaqeniet e kazaneve politike" janë fajtorë se i kanë keqpërdoruar këto raste.

Kaq në ekstrem e çoi kryeministri abstragimin e tij, sa vërtetoi se edhe tritolin e fundit në shtëpinë e Xhisielës e kishte vënë PD-ja, sepse vetëm asaj i interesonte të tregonte se vajza po mbahet peng.

Eshtë e njëjta logjikë si në vjesh-tën e 2014, kur ai hodhi në publik hipotezën se rrëzimin e avionit të Xhorxho Riforatos në Divjakë e kishin inskenuar demokratët, pasi nuk kishte mundësi tjetër që ai të binte në mes të ditës, gjatë fundjavës dhe në një plazh plot me njerëz.

Sado haluçinant të duket ky qëndrim, le të provojmë për një çast të shkojmë pas fijes së tij logjike.

Le të pranojmë se biseda e për-gjuar e Albert Veliut ishte një shpikje.

Le të besojmë se Saimir Tahiri është i pastër si bora dhe se e gjitha ishte një gënjeshtër e Dritan Zaganit.

Le të bindemi se Taulant Balla ka qenë për peshk dhe nuk ka shkelur kurrë në Krujë dy vitet e fundit.

Pra le t'i marrim këto të mirëqena dhe fajësojmë edhe ne "me-



jhanen e Shqiptit të shndërruar në kinostudio".

Të imagjinojmë për një çast se fajet e vetme në këtë vend i ka PD.

Por përsëri, as kështu nuk del llogaria.

Sepse pa u bërë dy vite denonci-me rresht, lidhja e Saimir Tahirit me Habilajt quhej një çmenduri. Sepse ata që guxonin ta shqiptonin, etiketoheshin si makineri balte dhe bashkëpunëtorë të një bashkëpunëtorë të trafikantëve.

Sepse pa u bërë zhurmë për denoncimin e "Babales", Agron Xhafaj do vazhdonte të ende ende

i lirë rrugëve të këtij vendi dhe do vijonte të bënte para me bizneset e tij, megjithëse kishte një vendim të formës së prerë në Itali.

Sepse pa u vënë gisht mbi Taulant Ballën dhe pa u denoncuar dhuna makabre, Xhisiela do vazhdonte të keqtrajtohej dhe askush nuk do pranonte ta merrte denoncimin ndaj përdhunuesit të saj me pushtet.

Natyrisht, shembujt e mësipërm nuk janë një justifikim i tezës se e keqja luftohet përmes së keqes. Se duhen prodhuar gënjeshtera për të shkuar tek e vërteta.

Por ato tregojnë se në rastin më të mirë vënia në vend e drejtësisë është ndihmuar nga denoncimet e kundërshtarëve të Ramës dhe se në rastin më të keq, pa "shpikjet" e tyre, keqbërësit do të vazhdonin të krekoseshin të pandëshkuar.

Ky është thelbi i problemit. Kjo është përgjigja që duhet të japë kryeministri: pse ai ka ngritur një sistem aq të korruptuar dhe të kriminalizuar, sa duhen "shpikur" stuhi të tëra për të t'u vënë në vend të vërteta të thjeshta.

Por, nga që s'bën dot këtë, Rama

merret me opozitën. Ndonëse, që prej zgjedhjeve të shkuara, ai nuk ka më punë me të. Që kur i kërkoi shqiptarëve votën për të bashkëqeverisur, ai llogarinë duhet ta japë para aleatëve të koalicionit të vet. Atyre duhet t'u shpjegojë, se pse nuk shkëputej dot nga Saimir Tahiri derisa problem in e tij ia ngritën në Berlin, se pse e favorizonte vëllain e ministrit dhe pse e mbronte djalin e deputetit?

Ai s'ka dot një përgjigje për "aleatin" e vet popull, prandaj ka shpikur gjetjen absurde: "Unë qeveris, fajet i bën opozita".



Opinioni **i** Ditës

Kosovë: Qeveria dhe opozita përpigjen të harmonizojnë qëndrimin për dialogun me Serbinë

Nga "Deutsche Welle"

(vijon nga faqja 1)

...Udhëheqësit kryesorë të institucioneve të Kosovës u bënë thirrje partive politike opozitare që ta mbështesin një rezolutë të propozuar nga qeveria, e cila e qartëson se çdo marrëveshje në dialogun me Serbinë të kalojë vetëm përmes Kuvendit. Në këtë rezolutë ku nuk përmendet askund emri i Presidentit të Kosovës thuhet se, "Kuvendi i Republikës së Kosovës insiston që dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë duhet të përmbyllet me një marrëveshje ligjore ndërkombëtarisht obligative, përmes së cilës do të ndodhë njohja reciproke ndërmjet Kosovës dhe Serbisë". Rezoluta përmban gjashtë pika, ku në fund thuhet se, "Kuvendi i Republikës së Kosovës është autoriteti suprem, i cili do të ratifikojë marrëveshjen ligjore ndërkombëtarisht obligative ndërmjet Kosovës dhe Serbisë".

"Kuvendi i Kosovës me votat e dy të tretave të deputetëve ratifikon marrëveshjet ndërkombëtare për këto çështje: territorin, paqen, aleancat, çështjet politike dhe ushtarake".

Kjo rezolutë, ndonëse akoma nuk është vendosur në kryesi, pritet të diskutohet këtë të enjte (11.10) në një takim të partive politike, i thirrur nga kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli.

E ky i fundit tha se rezoluta që është propozuar së bashku me partnerët e koalicionit, nuk duhet parë thjesht si një veprim politik i koalicionit qeverisës, por si një propozim në interes të shtetit. "Në këtë rezolutë jemi përpjekur që të inkadrojmë dhe harmonizojmë të gjitha pozicionet dhe deklaratat e shprehura në këtë periudhë, mbi çështjen e fazës finale të dialogut me Serbinë. Kohëzoni politik i brendshëm është i domosdoshëm për të mundësuar forcimin e pozicionit negociator të Kosovës, si dhe për të përbushur aspiratat që ne kemi për të zënë vendin që na takon në OKB, BE, NATO dhe forumet e tjera ndërkombëtare", thotë Kadri Veseli, duke i bërë thirrje opozitës "që të lënë mënjanë dallimet partiake dhe të bëhen pjesë e procesit të dialogut".

"Me sa duket nga qëndrimet publike, të gjitha partitë parlamentare e mbështesin në parim procesin e dialogut, por kanë dallime në qasje duke ofruar propozime të ndryshme rreth rezolutës për procesin e dialogut. Prandaj kam vendosur që të ftoj të gjithë udhëheqësit e partive parlamentare për të diskutuar e harmonizuar një rezolutë të përbashkët në Kuvend", thuhet në ftesën e kryetarit të Kuvendit, bërë partive politike parlamentare për një takim për ditën e enjte.

Edhe zëvendëskryeministri, Enver Hoxhaj thotë se në rezolutën



e propozuar nga partitë e koalicionit qeverisës për dialogun me Serbinë, Kuvendi i Kosovës do të ketë rol aktiv në këtë proces, pikërisht ashtu siç është kërkuar nga opozita dhe shoqëria civile.

"Ky dokument, që është hartuar nga partnerët e koalicionit përcakton edhe temat e panegociueshme në dialogun me Beogradin, që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian. Kundërshtimi i shprehur nga partitë opozitare për këtë rezolutë dëshmon se nuk ka 'vullnet politik' për t'u përmbyllur procesi i dialogut. Prandaj, sjellja e kundërt konfirmon se nuk ka vullnet politik jo vetëm për ta përmbyllur dialogun, por as për t'i dhënë rol Kuvendit, sikurse është

përsëritur në vazhdimësi", thotë Enver Hoxhaj.

Por, të kundërtën e zotit Hoxhaj e thotë kryetari i partisë më të madhe opozitare, Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) Isa Mustafa, duke e akuzuar vetë qeverinë që - sikurse ai thotë - po ia mundëson presidentit "që të përhapë idetë e tij për korrigjim kufijsh".

"Duke lexuar opinionet e ndryshme fitohet përshtypja se po bëhet garë se kush po i thotë më shumë e më fort presidentit se e ka keq me përhapjen kokëfortë të teorieve të tij shumë konfuze, por të rrezikshme, për korrigjim të kufirit me Serbinë, si zgjidhje e marrëveshjes përfundimtare. Që

e ka keq dhe gabim? E ka! Por shtrihet pyetja se kush ia dha shansin që ta ketë keq", shkroi në profilin e tij social Isa Mustafa. Ai thotë se qeveria u tërhoq nga obligimi i dialogut, që me Kush-tetutë dhe vendim të Kuvendit i takon asaj.

"Në fillim të këtij viti, qeveria i propozoi Kuvendit një platformë për dialogun Kosovë-Serbi pa asnjë përmbajtje, veç asaj se dialogun duhet ta udhëheqë Presidenti i Kosovës. Po të mos ishte kjo sjellje dhe ky veprim i qeverisë, ne s'do të kishim problem as me presidentin dhe as me teorinë dhe të butë të kufijve dhe as me ofertën për shkëmbim të territorit si pasojë përfundimtare e korrigjimit", thotë Isa Mustafa. Sipas tij, marrëveshja përfundimtare me Serbinë duhet të ndodhë bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, duke pasur parasysh efektet e saj për shtetësinë e Kosovës, por edhe për rajonin.

Sidoqoftë, Kosova dhe Serbia zhvillojnë dialog që nga viti 2011 në përpjekje për të përmirësuar marrëdhëniet ndërmjet tyre, kush ky i domosdoshëm i vënë nga Bashkimi Evropian që të dyja vendet, por edhe vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor të integrohen, përkatësisht të anëtarësohen në BE.

"Në fillim të këtij viti, qeveria i propozoi Kuvendit një platformë për dialogun Kosovë-Serbi pa asnjë përmbajtje, veç asaj se dialogun duhet ta udhëheqë Presidenti i Kosovës. Po të mos ishte kjo sjellje dhe ky veprim i qeverisë, ne s'do të kishim problem as me presidentin dhe as me teorinë e tij për korrigjim të madh e të butë të kufijve dhe as me ofertën për shkëmbim të territorit si pasojë përfundimtare e korrigjimit", thotë Isa Mustafa.

HOROSKOPI

DASHI

Duhet të nisni meditim dhe jogën për t'ju ndjerë mirë si fizikisht ashtu edhe psikologjikisht. Duhet të jeni të pavarur dhe të vendosni vetë për vendimet tuaja. Është dita e duhur për çiftet e dashuruar. Sot do të testoni inteligjencën me lojëra si, për shembull, shah.

DEMI

Përpiguri të kryeni aktivitete për t'u ndjerë mirë shpirtërisht. Gjendja financiare do t'ju përmirësohet në pjesën e dytë të ditës. Fëmijët do t'ju ndihmojnë në punët e shtëpisë. Me partnerin/partneren tuaj do të kaloni një ditë shumë këndshme dhe mbi të gjitha, do të tregohet shumë mbështetës ndaj jush.

BINJAKET

Mos u bëni nervoz dhe mos humbisni besimin, teksa do të takoheni me disa persona të profilit të lartë. Mos merrni vendime të rritura, sidomos kur bëhet fjalë për çështje financiare. Ka gjasë që të jeni të ngarkuar me disa punë në shtëpi, të cilat do t'ju zënë të gjithë ditën.

GAFORJA

Shmangni ushqimet me shumë kalori dhe kryeni sa më shumë ushtrime fizike. Dikush që i besoni shumë, nuk do t'ju tregojë të vërtetën plotësisht. Afërsia për të bindur të tjerët, do t'ju bëjë të zgjidhni disa probleme. Sjellja e bashkëshortes/bashkëshortit tuaj gjatë ditës së sotme do t'ju shqetësojë shumë.

LUANI

Do ta shijoni maksimalisht kohën tuaj të lirë. Ka gjasë që të nervozoheni gjatë një debati aq sa mund të humbni edhe qetësinë. Kontrolloni veten pasi mund të pendoheni për veprimet e rritura. Partneri/partnerja juaj mund t'ju surprizojë me një dhuratë të veçantë.

VRIGJERESHA

Përpiguri ta mbani veten në formë duke u nënshtruar një diete të shëndetshme. Prindërit dhe miqtë do të japin më të mirën e tyre për t'ju bërë të lumtur. Mund të zhgënjeheni në dashuri, por mos u shqetësoni pasi kjo situatë nuk do të zgjasë shumë.

PESHORJA

Do të ndihen shumë mirë nga ana shëndetësore. Tregoheni më të heshtur rreth investimeve dhe synimeve për të ardhmen. Fëmijët do t'ju bëjnë të ndihen kërenarë me arritjet e tyre. Ka gjasë që në jetën martesore të përjetoni disa momente të tensionuara.

AKREPI

Duhet të tregoheni shumë të guximshëm pasi mund të përballeni me disa probleme. Megjithatë mund ta kaloni duke menduar pozitivisht. Ka gjasë se do të merrni një propozim të rëndësishëm sot. Partneri/partnerja juaj do të tregohet shumë romantike.

SHIGJETARI

Është koha e duhur që personat e kësaj shenje që vuajnë nga zemra, të heqin dorë nga kafja. Sot do të merrni të gjithë vëmendjen që kërkon. Sa i përket lidhjes suaj romantike, duhet t'i kushtoni më shumë rëndësi partnerit/partneres suaj.

BRICJAPI

Mos u tregoni shumë kritik ndaj vetes pasi mund të rëndoni gjendjen tuaj psikologjike. Bashkëshorti/bashkëshortja juaj do të përpigjet t'ju gëzojë gjatë ditës. Shfrytëzoni të gjitha mundësitë tuaja për të dhënë më të mirën e mundshme në punë.

UJORI

Ankthi do t'ju largohet sapo të merrni situatën nën kontroll. Bëni kujdes me vendimet që do të merrni gjatë ditës. Sot do të përjetoni avantazhet e martesës, çfarë do t'ju bëjë të ndihen mjaft mirë.

PESHQIT

Sot do të ndihen të mbushur plot energji dhe çdo gjë do ta realizoni më shpejt se ç'e prisni. Në aspektin personal, do të përjetoni diçka me shumë rëndësi. Kjo nuk do t'ju lumtojë vetëm ju, por të gjithë familjen tuaj, partneren tuaj.

Gega u beson titullarëve me të cilët ka arritur sukseset e fundit, kjo ishte e katërta radhazi

Sërish Mala, Partizani mund Kukësin dhe fluturon në krye

Goli i mesfushorit në të 20'-ën vulosi fatet e ndeshjes



Jeton Selimi

Partizani rimerr ven din e parë, pasi ia dorëzoi përkohësisht Skënderbeut gjatë 24 orëve të fundit. Në "Elbasan Arena" të kuqtë e Skënder Gegës bëjnë atë që dinë të bëjnë më mirë, kontroll topi, presing i lartë dhe kalime pas shpinës së mbrojtjes. Rezultati? Fitorja e katërt radhazi në kampionat pas Flamurtarit, Tiranës dhe Teutës. Kryeqytetasit kanë ritmin e duhur dhe kanë gjetur çelësin për të çarë mbrojtjet kundërshtarë si pakush në këtë kampionat. Shpërthime nga krahët, filtrime në qendër, mbikalime pozicionesh të lojtarëve që çorodisin markuesit rivalë. E njëjta situatë edhe ndaj Kukësit. Armando Cungu bëri çmos që të shmangte humbjen, por edhe në ato pak raste që lojtarët e tij kaluan linjën e mbrojtjes, mendoi Alban Hoxha për ta mbaj-



tur rrjetën e paprekur. Momenti kulmor i sfidës së luajtur në Elbasan ishte në

minutën e 20-të, kur Jurgen Bardhi driblon Shametin dhe filtron një

top në zonë për Malën, që depërton në qendër dhe me një goditje të lehtë e të sak-

SUPERLIGA		
<i>TE DIELEN</i>		
Luftëtari - Skënderbeu	0-2	
Kamza - Flamurtari	2-2	
Tirana - Laçi	0-1	
Teuta - Kastrioti	2-0	
<i>TE HENEN</i>		
Kukësi - Partizani	0-1	
<i>RENDITJA</i>		
Skuadra	N	P
Partizani	8	19
Skënderbeu	8	17
Laçi	8	16
Kukësi	8	13
Flamurtari	8	11
Teuta	8	11
Tirana	8	8
Kamza	8	7
Luftëtari	8	6
Kastrioti	8	4

drat e tifozëve të kuq të pranishëm në stadium, duke e parandierë se ky gol do të ishte sërish vendimtar si në derbi. Loja vjen gjithnjë e në rritje dhe Partizani mund të kishte dyfishuar, ndërsa me kalimin e 2/3-ave të kohës së rregullt, të kuqtë nisnin të mendojnë më shumë për të mbrojtur rezultatit, ndërsa Kukësi i afrohet golit në minutën e 67-të, kur Shafik me kokë devijon keq përpara kuadratit të Hoxhës, ndërsa në minutën e 85-të është madhështor gardiani i kuq me pritjen e tij ndaj Shpehar, duke ruajtur të paprekur portën dhe duke futur në kasafortë trepikëshin e radhës, që e lejon Partizanin të ngjitet në kuotën e 19 pikëve, dy më shumë se Skënderbeu i vendit të dytë, ndërsa Kukësi mbetet i katërti me 13 pikë.

TRAJNERI I PARTIZANIT

Skënder Gega nuk zhbalancohet aspak. Tironierit të kuq fitorja e katërt radhazi i ka shijuar pa masë, por menjëherë pas saj, trajneri i Partizanit kërkon të fokusohet te ndeshja e radhës. Fjala titull edhe nëse mendohet, nuk thuhet me zë të lartë, pasi Gega dhe çdokush në klub e ka fare të qartë se ende nuk ka mbaruar njëra nga katër fazat, ndërsa pas përballjes me Luftëtarin, do të ketë përfunduar vetëm çereku i garës. Por vendi i parë mbetet vend i parë, ndonëse Gega me një batutë thotë se do të preferonte që të ishte fundi dhe jo fillimi i kampionatit!

Vendi i parë për Partizanin. Çfarë ndjesie është?

Unë mendoj se është ndjesi shumë e mirë. E kam theksuar se është fillimi dhe kemi edhe tri faza të tjera. Do të kisha dëshirë të ishim drejt fundit, por rëndësi ka që kemi një ecuri të mirë. Sigurisht që patëm probleme edhe ne. Kukësi ishte një ekip jashtëzakonisht i fortë. Luajtëm ashtu si dimë ne, me mënyrën tonë. Djemtë po përgjigjen dhe grupi

Gega: Titulli? Sikur të ishte java e fundit, por jemi ende në fillim

është në rruqën e duhur.

Fitore me rivalët direkt?

Kemi vështirësitë tona. Patëm një lodhje fizike. Doja t'i fteskoja. Mala ishte detyrim i detyrueshëm. Është një lojtar që na ndihmon në dy faza, megjithatë edhe në momentet më të vështira mund t'i godisnim.

Raporti midis dëshirës për të mbrojtur rezultatit apo dyfishimi? Mungon dëshira për ta dyfishuar?

Ke shumë të drejtë. Kemi lojtarë, ndoshta tek ne nuk kemi asnjë bomber, megjithatë kemi bërë mirë. Zgjidhet më lehtë me një sulmues që finalizon. Me të ardhmen e Hasanit, Malës dhe Bardhit që po bën kilometra pa fund do të ndryshojmë. Atë u thash pas ndeshjes, po të kisht besim, do të shënonit edhe të dytin. Jemi grup i ri dhe po ecim mirë.

Keni pikasur ndonjë lojtar, qoftë dhe jashtë vendit për të zgjidhur problem-in e finalizimit?

Kemi tri faza të tjera. Nëse ekipi ka nevojë dhe klubi e shikon të arsyeshme për ndryshime, do të bëhen. Nuk jemi absolutë dhe të përkry-

er, por është një lojë grupi, që unë personalisht dua që të luajnë në mënyrë kolektive. Jam i kënaqur tani me lojtarët e mi.

Keni luajtur me të gjithë rivalët? Kush është më i vështiri?

Çdo ndeshje ka pasur vështirësinë e vet. Edhe me Krujën hasëm vështirësi, pasi patëm një pjesë të dytë të dobët. Kukësi pati një ekip të mirë, na futi në presion. Ka ekipe të mira, rivalët i vlerësoj, megjithatë me të gjithë këta rivalë do të ndeshemi edhe tri herë. Duhet të kemi kujdes që të vlerësojmë çdo gjë.

Sjellja e lojtarëve në fushë me arbitrin?

E kërkoj çdo minutë që të jenë të disiplinuar. Jemi rritur në një sistem me një grup trajnerësh që na kanë edukuar. Është shumë e rëndësishme që ajo që shikoni ju në fushë është edhe pasqyrë e asaj që jemi jashtë fushë. Jemi shumë "OK", ka njerëz që japin kontribut të madh. Të gjithë e kuptojnë pozicionin e tyre, si një 20-vjeçar edhe një me eksperiencë po i respektojnë rregullat njësoj.

Trajneri i Kukësit pret përformime në merkato


Cungu e kap me Rexhinaldon: I duket vetja lider



pikëve nuk është e vogël. Do të vijë edhe momenti i kundërshtarit për të gabuar. Ndërprerja është në momentin e duhur për ne. Duam trofe dhe kjo s'duhet të jetë vetëm me fjalë, por edhe në fushë. Më parë ekipi nuk luante, merrte rezultat dhe kishte kritika, por edhe tani që bën lojë dhe nuk merr rezultat, ka kritika. Gabojmë dhe kemi tension në momentin final. Jemi ekip me djemtë rinj dhe po të shihen lojtarët që kanë arritur në verë dhe me objektivat që ekipi ka, janë lojtarë që premtojnë. Rexhinaldo është lojtar goli dhe ka luajtur mirë më parë. Në Korçë edhe këtë javë nuk ishte në

nivelin që pritet. Nuk ka munguar kritika nga ana ime, por mungoi mbështetja nga mbropa për të. Nëse do kishte më tepër konkurrencë, do të ishte më mirë, por ndoshta edhe mendon se është lider e thotë që pa mua nuk luhet futboll. Më mirë të humbë një lojtarë vendës se sa një i huaj. Rasti i Atandës? Mendoj se ishte penalti, megjithatë ai ishte vendimi i gjyqtarit. Nuk kam pretendime, sepse gjyqtarët kanë qenë mjaft korrektë si këtu, si në Korçë. Komplimente! Të jem i singërtë, është evidente dhe e nevojshme ndërhyrja në merkato, pasi kanë luajtur të gjithë. As Partizani nuk ka sulmues 'race', por të gjithë lojtarët dinë të shënojnë dhe ka lojtarë që dinë se çfarë është Superliga, apo edhe të rinj që marrin përgjegjësi e për të bërë diferencën. Shpërdorohen raste pa fund dhe ndërhyrja është evidente. Ne nuk bëjmë dot gol kur duhet vetëm ta fryjmë, e jo më ta godasim topin".

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- Dillon aktor.
- Një listë që zgjidhet nga regjisori
- Sigla e tritolit.
- Kapiteni që ndiqte balenën Moby Dick.
- Eshhtë spektatori i yni.
- Fillojnë lejen
- Një sinjal akustik.
- Një parashtesë për... përtej.
- Eshhtë partia e Sali Berishës.
- Kanë organizatën Hamas.
- Gëlojnë nga murgjit.
- Në teori kur mungon ti.
- Inicialet e A.Gide.
- Inicialet e Asimov.
- Nisen pa ne.
- Kreshniku i volejbollit.
- Kufijtë e tokës.
- Mund të jenë autonome të tilla.
- Britma e Arkimedit.

- Fillojnë vetëm.
- Bota jashtë ëndrrës.
- Mund të jenë ushtarake.
- Italia në Internet.
- Gjysmë atomik.
- Janë prova inteligjence
- Një libër hartash.
- Clapton i muzikës.

VERTIKAL

- I famshëm ai i Trojës.
- Një... bombë tenistike.
- Fillojnë themelet.
- Mund të jetë klasifikimi.
- Një letër... kampioni.
- Eshhtë pozicioni për gjumë.
- Janë diktatorët despotikë.
- Një kryeqytet afrikan.
- Që mesfushor i famshëm i Ajax.
- Ekstreme në tenis.
- Eshhtë e dëndur në xhungël.
- Eshhtë brinjë në skuadër.
- Eshhtë pako që dërgohet.
- Brown i Kodi i Da Vinci-t.
- Bëjnë taktika me taka.
- Vetot pa kufij.
- Persekutonin romakët.
- Eshhtë gri ajo e trurit.
- Një mund të jetë spiuinzi.
- Janë vendet për nisje.
- Me to bëjnë torta.
- Janë katër në kitarë bas.
- Institucione Urbane Rajonale.
- Priten me lotë në sy.
- Një rreth pa ekstreme.
- Gjysmë kasate.
- Eshhtë cilësia.
- Ente Tregtare Lokale.
- Një pjesë e territorit.
- Në hyrje të oazit.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- Jagger i Rolling Stones.
- Zanore për kuaj.
- Janë dhelpra.
- Inicialet e Lendl ish tenist.
- Kufizojnë rastet.
- Mbyllen me epilog.
- Eshhtë simbol ngadalësie, por jo breshkë.
- Gjysmë njeriu.
- Janë fruta ekzotikë.
- Një minierë e vjetër.
- Ata tanë ishin ilirë.
- Masat pa kufij.
- Një gëzim i madh.
- Agjenci Ndërmjetëse Përmët
- Eshhtë godinë në miniaturë
- Film i Ridley Scott
- Duken të gjata në pritje.
- Njëzetmije... në det në një libër të Jules Verne.

VERTIKAL


- Një legjendë.
- Përfundojnë një stil.
- Nuk e ulin kokën.
- Këndohen në opera.
- Janë tek në Somali
- Eshhtë lloj papagalli.
- Mbyllin komentin.
- Eshhtë e parë për prodhim.
- Kush ka do të pijë.
- Janë binarë.
- Rolet pa ret.
- Vihen për të mbyllur të tilla.
- Janë tek në mantel.
- Salgari që krijoi Sandokan.
- Një stinë e ngrohtë.
- Janë pamje nga puna.
- Një fjalë goxha.
- Ato Eilliams janë teniste
- Ishin të parët tanë.
- Janë edhe ato polare.
- Fillojnë nazet.
- Inicialet e Triolet.
- Një bëhet me pozë.
- Mbyllin punimet.
- Nodoh në kufij.
- Perignon i champagne-s.
- Eshhtë iks ajo e sulmit.
- Enti europian i hapësirës.
- Fillojnë lehtë.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

		3		4				
2			3	6				
					9	2		4
	5	4						8
	7		8					
8						1	7	6
7		9			1	6		
4					7			
	3	5	2			9	1	

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

2	3	8	4	6	9	5	7	1
6	9	1	3	5	7	4	2	8
7	4	5	8	1	2	3	9	6
9	1	3	5	7	8	2	6	4
8	5	6	9	2	4	7	1	3
4	7	2	1	3	6	8	5	9
3	8	7	2	9	1	6	4	5
5	2	9	6	4	3	1	8	7
1	6	4	7	8	5	9	3	2

Argëtimit filozofik

- Nëse i mohon të vërtetën një femre, dije se ajo do të bëjë të besosh vërtetë gënjeshtrat e sajë
- Në varrimin e së vërtetës, gënjeshtra mbajti një fjalim prekës
- Nuk ka rëndësi se kush, mjafton që dikush të dëgjon me të vërtetë..!
- Mos lejo kurrë që zemra të vendosi 'presje' aty ku mendja është e sigurt që duhet vendosur 'pikë'
- Nëse e bën një femër të buzëqeshë, gjithmonë ke vend në zemrën e saj...

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

15	S	A	I	S	8		14	4		14		7	4	15
4	11	4			1	5	12	2	3	14	5			10
10			1		4	1	2	8	10	6	4	7	5	
4	7			1	7	5	8	9	4	2	10	4		
15	3	1			6	2	10	5	2	6				12
	7	1	11	13	5			1	5		17	15	1	
17	3	10	13	3		4	4		4	10	6	3		
4		2	4	7		11		6	10	4	2	4		
12	1	5	16	4	10	5		4	4	8	16			
14	4	7	4		8	14	5		17	3	10	10		
4	11	4	7	6	2	6	1	5		7	5	4		
3	4	2	5			4	1	2	8	10	6		2	

R	A	S	T	E	T		P	A		P		
U	R	A	T		U		R	H	P	A		
S	A	M		M		M	A	R	A	I	S	
I		A	M	E	R	I	K	A	N	E	T	
		P	R	O	T	E	S	T	A	N	T	E
G	J	I	G	A	N	T	I		I	R	U	
B	E	T	O	N		E	K		B	O	R	
	S	A	L	I		R	A	M	A			
T	O	N			T	I	T	U	L	L	I	
A	R	E	S		A	O				E	R	
P	J		A	R		Z	O	T	I	M	I	
A	A		M	E	R	E	N	G	U	E	S	

PËRGJIGJET E FJALËKRYQVEVE TË NUMRIT TË KALUAR

N	E	N	T	O	K	A	A	S	C	E				
T	R	U	P		T	A	L	E	N	T	E	S		
O	R		K		P	A	N	T	E	R	A	T		
K	E	L		K	A	N	D	I	L	E	T			
B	A	K	U	N	I	N	A	D	A	M				
T	A	M	A	R	O	C	O	O	A	K				
M	E		T	E	O	N	A	T		N	D	U		
A	T		T	O	N	I	K	E	P	I	E	R		
K	E	L	E	V	A		D	E	T	I	E	I	R	
K	E	L	S	A		P	A	L		N	O		A	
T	A	T		P	I	R	A	T	E	R	I	A		
T	I	R	A	N	A		H			R			P	
O	R	A	R	I		B	T	E	A	T	E	R		
R	O	M	A		K	A	B	I	R	B	E	D	I	
T	N	A		B	A	R	I	T	O	N	I	L		
U	I		R	A	M	B	O						L	
R	A	D	I		P	A	G	A	N	I	Z	M	I	
A		V		E	R	R	A	L	A				I	
T		P	A	R	T	I	A	K		I	N	A	T	
L	A	L	A		F	E	M	R	A		H			
P	E	L	I	K	A	N	I		I	T	H	E		
M		I		J	A	S	O	N						
A	P	A	R	A	T	E		P	A					R

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

Thënie të mençura

- Forca shpirtërore s'është gjë tjetër, veçse arti për të mbajtur mbyllur në zemër shqetësimin
- Nuk ka ilaç që mund të shërojë atë që nuk shëron dot lumturia...!!
- "Kurrë më!" -Thoshte vullneti i lodhur..
- "Edhe një herë.." -Lutej zemra duke rënkuar..
- Të pamposhturit janë ata që tregohen të fortë, kur sulmohen në pikat e dobëta
- Më pëlqente. Duke një tip interesant derisa filloi të flasë... Çfarë mallkimi!

